

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7359 E hënë 20 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Më 18 nëntor, në fshatin Kukël të Zadrimës, pikërisht në mjediset ngrehinës që ka qenë shtëpia e Mjedës, tashmë e kthyer në Qendrën Muzeore "Dom Ndre Mjeda"...

Vijon në faqen 20

Nga GJOVALIN SHKURTAJ

"Shqyptarija", liria e shqipja në jetën e Dom Ndre Mjedës



Opinion **Ditës**

Sjellja skandaloze e Serbisë si shtet heqemion në Ballkan demonstron jo vetëm nga përpjekja për të dalë si protektori i rajonit, por edhe si shteti që vendos të...

Vijon në faqen 21

Nga SHABAN MURATI

Linçimi serb i Izetbegoviçit dhe heshtja shqiptare



Ish-kryeministri: T'i hiqet mandati si deputet

Pse u "arratis" Tahiri, avokati: S'ka urdhër që t'i ndalojë lëvizjen

Prokuroria: Nuk na lejuan arrestimin e ish-ministrit, masat e tjera pa vlerë

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri është kthyer në Tiranë të dielën mërzë, duke larguar çdo dyshim për një arratisje të mundshme nga Shqipëria. Ish-ministri i Brendshëm u largua nga vendi për të vizituar babain e sëmurë, që kurohet në Gjermani. Udhëtimi jashtë Shqipërisë i Saimir Tahirit...

GJYKATA KUSHTETUESE RREZON PADINE, LIHET NE FUQI VENDIMI UNIFIKUES

RILLOGARITJE PENSIONESH PER 20 MIJE ISH-USHTARAKE

Preken të gjithë ata që janë liruar nga detyra që pas vitit 1991 e deri më sot. U takonte pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi



(Në foto) Ish-ushtarake gjatë një proteste

FLET DEPUTETJA SHKODRANE

Topalli jashtë Kuvendit, Ulqinaku: I dobishëm ndryshimi i elitave. Ruçi kryetar? E neveritshme

Në faqen 4

NE KERMIM AUTORET

Grabiten 4600 euro në teatrin "Skampa", financierja: Janë të miat, i ruaja në zyrë

Në faqen 8

TRONDITET ARTI

Atak kardiak, ndahet nga jeta kompozitori Aleksandër Lalo

Në faqen 19

"LIFE PAGES"

Mjekja reumatologe: Pse na dhembin pa shkak kokcat e si mund të trajtohen

Suplement

"QE NGA 2009, NE PRITJE TE PENSIONIT SPECIAL"



Gëqo Bushaka, fëmija i trishtuar që u bë shkrimtar. Rrëfimi i "babait" të Çufos

Në faqet 18-19

Kryetari i Degës së V, Kapllan Sako: Kthym në Jugosllavi 12 kosovarë dhe 3 grekë

"Si u dënua Daut Gumeni me grupin për akte terrori"

Zbulohet dokumenti i Sigurimit të Shtetit i 1970-s, dërguar Hysni Kapos

Nga DASHNOR KALOÇI

Gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist të Enver Hoxhës, që nga viti 1945 e deri në vitin 1990-të, kur nisi dhe Lëvizja Studentore, në varësi të konjunkturave e ngjarjeve politike që ndodhin në arenën ndërkom-



EKSKLUZIVE

bëtare. Sigurimi i Shtetit nën udhëheqjen e PPSH-së ndërmerre "zbulime", arrestime dhe goditje "grupesh armiqësore", të cilat pothuaj në më të shumtën e rasteve i inskenonte vetë, duke i paraqitur ato si mjaft të rrezikshme. Dhe si...

Në Faqet 10-11

DIPLOMACIA INVESTIMET

Kreu i PD: Rama i pashpresë, në Shqipëri investojnë ata që i dorëzojnë 50% të fitimit

Investimet e huaja, Basha: Mision i pamundur për ambasadorët

"Korrupsioni përkeqësoi klimën e biznesit"

Valentina Madani

Kreu e opozitës, Lulzim Basha, e konsideron mision të pamundur që ambasadorët të sjellin investime të huaja në Shqipëri. Basha akuzon kryeministrin Rama si përgjegjës për mungesën e investimeve të huaja. Basha shpjegon se klima për bizneset e huaja është përkeqësuar në këto katër vite të fundit, për shkak të korrupsionit, rritjes së taksave. Z.Basha reagoi dje pas deklaratave të kryeministrin Edi Rama për ambasadorët, ku këta të fundit duhet të "tërheqin" sa më shumë investitorë të huaj në vend. Në një mesazh në faqen e tij të "Facebook"-ut, Basha thekson se ky është një mision i pamundur për ambasadorët. Basha shtoi se kryeministri e di se në Shqipëri mund të investojnë apo marrin tendera vetëm ata që pranojnë të dorëzojnë kapar 30-50% të fitimit tek ai. "Është mision i pamundur që ambasadorët të sjellin investitorë të huaj në Shqipëri! Rama e di shumë mirë këtë, sepse është ai përgjegjës për krijimin e një klime armiqësore për biznesin vendës dhe të huaj. Kryeministri i pashpresë dhe i korruptuar deri në rrenjë, e di se në Shqipëri mund të investojnë apo marrin tendera vetëm ata që pranojnë të dorëzojnë kapar 30-50% të fitimit tek ai, përmes sejmëve të tij të kapur në përgjime", shprehët z.Basha. Sipas tij: "Ambasadorët e kanë mision të pamundur sjelljen e investitorëve të huaj, sepse në 4 vitet e fundit raportet ndërkombëtare flasin vetëm për përkeqësimin e klimës së biznesit, për rritjen e taksave, për korrupsionin e përhapur në çdo nivel të qeverisjes. Sepse tenderat dhe koncesionet përfundojnë në xhapat e 10 klientëve të kryeministrin dhe investitorët e huaj gjytohesh nga kriminelët e lidhur me Ramën dhe Dakot e tij për t'u përzënë nga Shqipëria". Kreu i PD-së përmendi se: "Gjatë



Kreu e opozitës, Lulzim Basha

SALI BERISHA

Pas takimit të kryeministrin Rama me ambasadorët, të cilëve u kërkoi të sjellin investitorë të huaj në vend, reagoi ish-kryeministri Berisha. "Në katër vite, zero investime të huaja të reja në Shqipëri! Investitorët e huaj nuk i lejon droga, korrupsioni dhe dajakua që të vijnë në Shqipëri", shprehet z.Berisha.

"Arsyet e largimit të investitorëve të huaj"

Petrit Vasili: Krimi është bërë njësh me pushtetin

Për kreun e grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, fjalimi i kryeministrin Edi Rama në takim me ambasadorët ishte shumë gesharak, pasi krimi në krye të qeverisë largon dhe përzë investimet e huaja. Vasili komentoi deklaratën e kryeministrin Edi Rama me ambasadorët për të tërhequr sa më shumë investitorë të huaj në Shqipëri. Vasili në një status në faqen e tij të "Facebook"-ut theksoi se është krimi në krye të qeverisë, ai që ka larguar investimet e huaja nga vendi. Mes të tjerash, Vasili pohoi se investimet e huaja largohen, pasi pushteti i grabit me taksa e rryshfete pa fund. "Krimi në krye të qeverisë



largon dhe përzë investimet e huaja. Që droga dhe krimi i organizuar janë ulur këmbëkryq në Shqipëri e thotë BE, SHBA, OSBE dhe e gjithë media botërore. Kur e thotë opozita shqiptare si-

pas kryeministrin dhe ca e ca të tjerëve, që i rrinë nga pas është faj, gabim, herezi. Po, po, droga dhe krimi i bërë njësh me pushtetin po e shkatërrojnë vendin. Përgjegjësia ka vetëm një emër që është kryetrafikanti, që urdhëroi të pengohej drejtësia për ish-ministrin e akuzuar nga Europa. Edhe për këtë, e gjithë Europa po flet. Ndaj largohen investimet e huaja, sepse pushteti i grabit me taksa e rryshfete pa fund, ndërsa krimi i mbështetur nga qeveria i rreh dhe i gjymton. Fjalimet e kryeministrin për diplomaci ekonomike janë humor, ku qeshin e gëzojnë trafikantët dhe qajnë e hidhërohen shqiptarët".

qeverisjes tashmë të vdekur të Ramës, në Shqipëri nuk erdhi asnjë investim serioz i huaj. Po të mos ishin dy projektet e mëdha energjetike, gazsjellësi Trans Adriatik dhe Kaskada e Devollit, niveli i investimeve do të ishte në minimum historik, duke kthyer vendin 15 vite prapa". Më tej Basha thekson: "Ambasadorët e Shqipërisë

e kanë mision të pamundur sjelljen e investitorëve të huaj, sepse për shkak të keqqeverisjes së Ramës, vendi është në depresion ekonomik dhe social. Rreth 300 mijë shqiptarë të larguar në 4 vjet nga Shqipëria janë prova ulëritëse e këtij realiteti dëshpërues". Në gjykimin e Bashës: "Investitorët e huaj do të vijnë në

Shqipëri, kur vendi të ketë një qeveri që lufton krimin, hap vende pune dhe u jep mundësi të gjithëve. Por kjo nuk do të ndodhë përse kohë vendin ta drejtojë kryeministrin i kapur nga krimi dhe i zhytur në krim, që ktheu Shqipërinë në hambar droge dhe buxhetin e shqiptarëve në lavatracë për pastrimin e parave të pista".



Kryeministri Edi Rama gjatë takimit me ambasadorët e Shqipërisë në botë



PD, Tabaku: Qeveria pranoi dështimin me investimet e huaja

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorinda Tabaku, reagoi me një status në "Facebook", duke akuzuar qeverinë për dështim me investimet e huaja. Sipas saj, ministri i Financave ka pranuar se investimet e huaja janë në pikën zero. Deputetja shpjegon se fajin për dështimin e thithjes së investimeve nga vendet e tjera e kanë taksat e larta dhe vendimet e qeverisë që promovojnë ulje taksash vetëm për një numër të vogël biznesesh. "Më në fund, ministri i Financave e pranon që investimet e huaja pas 2013-ës janë në pikën 0. Por, si të gjithë fajtorët e paturp, ua hedh fajin të tjerëve, për atë që ka vetëm një fajtor. Qeverinë dhe kryeministrin! Fajin për dështimin me investimet e huaja e kanë taksat e larta, e kanë vendimet e qeverisë që promovojnë ulje taksash vetëm për një numër të limituar biznesesh të zgjedhura nga qeveria, e rritje taksash për të tjerët. Fajin e ka korrupsioni në sektorin fiskal. Fajin e kanë burimet e pandershme të financimit e paratë e drogës që financojnë ndërtimin dhe gjoja projekte 1 miliard euro", tha zj.Tabaku. Ajo përmendi se, "opozita ka ngritur këtë shqetësim prej kohësh dhe qeveria e ka mohuar. Ju keni mbyllur veshët e keni kënduar të njëjten muzikë të përparimit, prandaj ka vetëm një fajtor për këtë dështim, qeveria dhe mënyra se si keni zgjedhur të qeverisni. Taksat e ulëta, ndershmeria ndaj biznesit, angazhimi serioz për investime të huaja sollën si TAP edhe 'Starcraft', që sot mbajnë në këmbë ekonominë. Për sa kohë të kemi këtë qeveri, gjithnjë e më pak investitorë të tillë do të vijnë", tha Tabaku.

AKUZA

"Taksat e ulëta, ndershmeria ndaj biznesit, angazhimi serioz për investime të huaja sollën si TAP edhe 'Starcraft', që sot mbajnë në këmbë ekonominë. Për sa kohë të kemi këtë qeveri, gjithnjë e më pak investitorë të tillë do të vijnë", tha Tabaku.

Kontroll bizneseve të mëdha, kryeministri: Fshehin pagën reale të punonjësve

Diplomacia ekonomike, Rama thirrje ambasadorëve: Sillni investime

"Forca e ligjit do godasë fort informalitetin"

Kryeministri Edi Rama gjatë takimit me ambasadorët e Shqipërisë në botë u kërkoi atyre që të marrin një rol të ri për të ridimensionuar diplomacinë ekonomike dhe nevojën që ka vendi për të thithur investime të huaja. Ndryshe nga takimi i muajit gusht, ku nuk i kurseu kritikën për trupën diplomatike, kryeministri u shpreh optimist për nisjen e një faze të re në shërbimin e jashtëm. Në aktivitetin me temë "Ridimensionimi i Diplomacisë Ekonomike Shqiptare: Sfidë dhe Mundësi", në "Tirana Business Park", kreu i qeverisë u ndal tek rëndësia e tërheqjes së investitorëve të huaj në sektorët e ndryshëm prioritarë të ekonomisë. Kryeministri u shpreh se është i rëndësishëm promovimi dhe zgjerimi i eksporteve dhe njohja e Shqipërisë si destinacion turistik gjatë të gjithë vitit, ndërsa do të ketë shpërblim për ambasadorët më të suksesshëm. Për Ramën, kjo është një rrugë e re, e cila do të kërkohet kohë, por do të sjellë rezultatet e pritura me vullnet dhe bashkëpunim mes ambasadorëve me qeverinë dhe bashkitë. Shefi i qeverisë theksoi se ka interes për investime në Shqipëri në turizëm dhe në energji. Kryeministri Rama tha se është i rëndësishëm promovimi e zgjerimi i eksporteve dhe njohja e Shqipërisë si destinacion turistik gjatë të gjithë vitit. "Shërbimi i jashtëm duhet të mbështesë investimet e huaja dhe zhvillimin ekonomik, duke bashkëpunuar me qeverinë dhe bashkitë e vendit. Ridimensionimi i diplomacisë ekonomike nuk është objektiv që mund të përmbushet thjesht nga diplomatët, por kërkon kalimin në një nivel tjetër të koordinimit me ministrinë, që janë të përfshira drejtpërdrejt në funksion të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së investimeve të huaja. Çdonjëri nga drejtuesit e misioneve, çdo ambasador duhet të kuptojë rëndësinë e madhe të rolit të tij për të ndihmuar duke këmbëngulur në kalimin sa të shpejtë të kësaj faze tranzitore, që duhet t'i vihet në shërbim procesit të ndërveprimit. Në promovimin e Shqipërisë, me një rëndësi të veçantë është edhe rritja e eksporteve", deklaroi z.Rama. Kryeministri përmendi sektorët ku duhet të investohet më tepër nga të huajt. "Ne kemi sot një bazë të rëndësishme për të bërë të mundur që të komunikojmë me fakte në dorë me të gjithë ata që janë të interesuar lidhur me potencialin dhe oportunitetet që ofron vendi ynë. E kemi vënë re dhe e konstatojmë në mënyrë të përditshme që ka



Kryeministri Edi Rama

DONALD LU

"Kompanitë amerikane e kanë njohur me kohë potencialin në naftë dhe gaz të Shqipërisë. Ju keni mbështetjen tonë dhe ne e mirëpresim angazhimin tuaj për të përmirësuar kushtet për një garë të barabartë, me standarde të larta mjedisi dhe etike", deklaroi ambasadori Donald Lu gjatë seminarit "Kornizat fiskale dhe kontraktuale për zhvillimin e sektorit të naftës".

DITMIR BUSHATI

Në përfundim të takimit tregitor, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati bëri një përmbledhje të rezultateve arritura gjatë diskutimeve, duke e vënë theksin në domosdoshmërinë për një qasje të re tashmë, të filluar në kontekstin e diplomacisë ekonomike dhe nevojën e hartimit të një organizimi të ri të punës së përfaqësive tona në këtë drejtim.



Bruksel, axhenda e delegacionit shqiptar me Hahn e Kukan

Për dy ditë me radhë, një delegacion shqiptar i udhëhequr nga kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla dhe me pjesëmarrje të kryetarëve të grupeve parlamentare të PD-së dhe LSI-së, Edmond Spaho dhe Petrit Vasili, do të zhvillojnë një takim dyditor të nivelit të lartë në Bruksel, me temë integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Në ditën e parë të takimit do të mbajë fjalën e tij edhe presidenti i Parlamentit Evropian Antonio Tajani, i cili do të shprehë gëzimin për darrë në nder të të ftuarve. Siç caktohet në axhendë, takimi për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor do të jetë 2-ditor, ndërsa nesër në orën 15:10 fjalim do të nisë Antonio Tajani, presidenti i Parlamentit Evropian. Në ditën e dytë të tryezës së rrumbullakët do të mbajë fjalën tyre komisioneri për Zgjerim Johannes Hahn, si dhe euro-parlamentari, Eduart Kukan. Fjala përshëndetëse do të jepet nga David McAllister, kreu i Komitetit të Çështjeve të Jashtme.

Takimi me ambasadorët, kritika e Majkos: Nuk dini ku janë emigrantët

Pandeli Majko kritikoi dje ambasadorët sa u përket lidhjeve me emigrantët dhe diasporën. Ai kërkoi më tepër angazhim nga diplomatët dhe informacion për shqiptarët që jetojnë jashtë. Në mblyllje të aktivitetit tregitor me ambasadorët për "Diplomacinë Ekonomike" ishin të pranishëm edhe kryeministri Rama dhe ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko. Sipas tij, ambasadorët nuk kanë as informacion se ku ndodhen emigrantët, apo aktiviteti i tyre. "A keni një regjistër për organizatat e komunitetit shqiptar në vendet që mbulon ambasada tuaj? Cilat janë aktivitetet që organizoni me komunitetin shqiptar, përveç ditës së flamurit kombëtar? A i keni takuar ndonjëherë mësuesit e gjuhës shqipe në vendin ku ju punoni si ambasadorë? A



KRITIKA

Ministri për Diasporën, Pandeli Majko kërkoi më tepër angazhim nga diplomatët dhe informacion për shqiptarët që jetojnë jashtë. Sipas tij, ambasadorët nuk kanë as informacion se ku ndodhen emigrantët, apo për aktivitetin e tyre.

një rritje të ndjeshme të interesit për të investuar në vendin tonë, veçanërisht në turizëm. Pa diskutim edhe në sektorin e energjisë apo të naftës, që ka ndodhur edhe më parë për hir të së vërtetës dhe besoj që ne duhet të fokusohemi fort te turizmi, tek manufaktura,

te zhvillimi rural dhe në radhë të parë këtu kam parasysh zhvillimin e industrive përpunuese, ku kemi ende një boshllëk shumë të madh", tha z.Rama. **PARALAJMËRIMI** Kryeministri Edi Rama paralajmëroi dje se në fillim të janarit do të vendoset

kun me migracionin shqiptar, nuk ka mundësi që si shtet të arrijmë standardin evropian. Ne gënjëjmë veten se mund të jemi të gatshëm për integrimin evropian, kur nuk dimë të flasim shqip me bashkëkombësit tanë që kanë shtetësi të vendeve perëndimore", deklaroi z.Majko.

TVSH për biznesin e vogël, që sipas tij do të luftojë informalitetin. Gjatë komunikimit javor, ai tha se në janar tradita e biznesit të madh që punon me dy bilance do marrë goditje të fortë dhe qeveria do njohë vetëm bilancet e bankave. Afërsisht, 42 mijë punonjës marrin

pagë minimale në Shqipëri, pra 30 mijë lekë. Shifrën e bëri publike Edi Rama, duke paralajmëruar një fushatë kontrollesh ndaj bizneseve që fshehin pagën reale të punonjësve të tyre. "E kemi bërë të ditur objektivin tonë për të luftuar informalitetin dhe mundësinë për më shumë janë të mëdha. Është miratuar baza në Kuvend dhe prej janarit do të përfshihet edhe biznesi i vogël dhe vlera e shtuar e aksionit anti-informalitetit. Me gjithë arritjet e konsiderueshme, si dhe në luftën kundër punës në të zeze, së fundi janë identifikuar rreth 40% e të punësuarve në bizneset e mëdha të deklaruar me pagë minimale 30 mijë lekë. Kjo është e pajustificueshme, por edhe e dënueshme, pasi shkelen hapur të drejtat e punonjësve, duke iu ngrënë padrejtësisht pensionin, duke i bërë bisht pagesës për tatimin e fitimit. Bashkë me ekonominë po rritet edhe forca e institucioneve. Gropa e detyrimeve mbetet e një madhësi të papranueshme për një vend. Puna duhet të paguhet denjësisht dhe duke respektuar ligjet. Në janar tradita e biznesit të madh që punon me dy bilance do marrë goditje të fortë. Qeveria do njohë vetëm bilancet e bankave dhe duhet të ketë përputhshmëri. Forca e ligjit do të ushtrohet më fort se asnjëherë më parë për çdo biznes që do gjendet në kushtet e mashtimit me pagat dhe me detyrimet", - theksoi z.Rama.

OPOZITA
INTERVISTA

Mbesa e dëshmorit Nazmi Kryeziu: Zgjedhja e Ruçit, shfaqja më e neveritshme

Topalli jashtë Kuvendit, Ulqinakun: I dobishëm, ndryshimi i elitave në PD

"Risja ime në politikë dhe angazhimet për Shkodrën"

Valentina Madani

Izmira Ulqinakun, jeta mes Tiranës dhe Shkodrës e ka afruar më shumë me njerëzit. Politikën e nisi kur ishte 18 vjeçe dhe jo rastësisht arkitetja që kishte punuar në Bashkinë e Shkodrës u gjend në listën e kandidatëve për deputetë të PD-së. Por, befasishtë ndodhën kur 26-vjeçarja hyri për herë të parë në Parlament. Mbesa e dëshmorit Nazmi Kryeziu, që mbeti i vrarë në masakrën e 2 prillit në Shkodër, nuk do ta mendonte kurrë që një ditë Parlamenti ku ajo tashmë bën pjesë do drejtohej nga ai që kishte qenë në krye të Ministrisë së Brendshme kur ndodhi vrasja e të afërmit të saj. Deputetja e PD-së tregon për "Gazeta Shqiptare" edhe për njohjet me ish-deputeten Jozefina Topalli, ndërsa vlerëson se "një ndër gjërat më të dobishme në një demokraci është ndryshimi i elitave, besoj se do të ketë Parlamenti dhe politika më shumë frymëmarrje".



Deputetja e PD-së, Izmira Ulqinakun

Nga arkitekte, në politikë. A ishte i vështirë ky kalim për Izmira Ulqinakun?

Për mua arkitektura dhe politika ecin paralelisht. Janë dy dashuri që s'mund t'i ndaj. E përbashkëta e tyre është planvendosja. Si qëndron objekti në zonë është ekuivalente me atë sesi politika duhet të përshkruhet me qytetarët e vendit. Ndërtimi dhe vizioni janë elementet bazë të arkitektures dhe politika mbi këto elemente ngrihet, ose duhet të ngrihet, ndërtim dhe vizion. Ndërsa të qënurit zëdhënësë më ka ndihmuar shumë, pasi ka qenë një lloj shkollë politike për mua.

Cilat janë lidhjet tuaja me Partinë Demokratike?

Unë kam lindur në 1991, viti kur u ndjen hapet e para të Partisë Demokratike. E them këtë, pasi jam ndërjetëgjithmonë pjesë e Partisë Demokratike. Kam lindur në një familje të djathtë historikisht, ish-të perseku-

tuar. S'kishte si të isha ndryshe edhe unë. 18 vjeçe u bëra pjesë e strukturave të PD-së në Shkodër, me dëshirën e madhe që t'i bashkohem partisë së lirisë së individit.

Shumëkush ato ditë mendoi se ju e zëvendësuar Jozefina Topallin në Shkodër, pasi ajo mbeti jashtë listës së kandidatëve për deputetë. Ka diçka të vërtetë në këtë rast dhe cila është njohja juaj me Topallin?

Nuk besoj se votuesi demokrat në Shkodër të jetë i lidhur me emra të veçantë. Mjafton të kujtojmë se Partia Demokratike vazhdimisht ka pasur ndryshime të mëdha në listat e deputetëve, apo emrat e kryetarëve të bashkisë në Shkodër (besoj se më shumë se kudo tjetër) dhe ka fituar gjithmonë. Unë jam njohur me Znj. Topalli që kur kam qenë në forum rinor. Ajo ka sjellë një kontribut të madh në politikën shqiptare, por siç e përmenda, listat e deputetëve kanë pësuar çdo herë ndryshime. Një ndër gjërat më të dobishme në një demokraci është ndryshimi i elitave, besoj se do të ketë Parlamenti dhe politika më shumë frymëmarrje.

Cilat politikë kanë të PD-së i njihim më tepër para se të hyjnë në Parlament dhe a jeni miqësuar me pjesën

tjetër të deputetëve të djathtë?

Theksoj që në grupin parlamentar ndihem mjaft mirë. Ka një frymë pozitive dhe jemi të gjithë në të njëjtën linjë, për një opozitë të fortë. Gjatë kohës që kam qenë zëdhënësë jam njohur me figurat kryesore të Partisë Demokratike, ndërsa tani të qënurit bashkë pothuajse gjatë gjithë javës në komisione dhe seanca parlamentare na bën që të miqësohemi më shumë me njëri-tjetrin dhe të ndajmë ide dhe mendime për një performancë sa më të mirë të grupit parlamentar.

Si ishte për ju, si mbesa e dëshmorit Nazmi Kryeziu, seanca e parë plenare kur u votua Gramoz Ruçi në krye të Kuvendit? Si e konsideroni emërimin e tij?

Zgjedhja në krye të Parlamentit shqiptar e një figure si ajo e Gramoz Ruçit është për mua shfaqja më e neveritshme dhe më e qartë sesi kjo mazhorancë ndihet si pasardhësë e drejtpërdrejtë, jo vetëm si bijtë e etërve, por edhe në mendësinë komuniste. Zgjedhja e Gramoz Ruçit ka qenë dhe mbetet përsa kohë që ai të jetë në krye të Parlamentit, një fyerje për qindra mijëra shqiptarët që kanë qenë viktime të luftës së klasave dhe

PËR RUCIN

"Zgjedhja në krye të Parlamentit shqiptar e një figure si ajo e Gramoz Ruçit, është për mua shfaqja më e neveritshme dhe më e qartë sesi kjo mazhorancë ndihet si pasardhësë e drejtpërdrejtë, jo vetëm si bijtë e etërve, por edhe në mendësinë komuniste", tha deputetja e PD-së.



PËR TOPALLIN


Përrjashtimi

"Unë jam njohur me Znj. Topalli që kur kam qenë në forum rinor. Ajo ka sjellë një kontribut të madh në politikën shqiptare, por siç e përmenda, listat e deputetëve kanë pësuar çdo herë ndryshime. Një ndër gjërat më të dobishme në një demokraci është ndryshimi i elitave, besoj se do të ketë parlamenti dhe politika më shumë frymëmarrje", tha zj. Ulqinakun.

të gjithë atyre që luftuan për përmbysjen e diktaturës hoxhiste në Shqipëri.

Çfarë u premtoni shkodranëve si zëri i tyre në Kuvend? A përbën problem për ju që jeni në opozitë, ndërkohë që Shkodra ka dy përfaqësues të tjerë në qeveri, zëvendëskryeminstren Mesi dhe ministrin Bushati?

Shpreh vendosmërinë time të palëkundur të jem zëri aktiv, gjithëpërfshirës dhe realizues i të rinjve, të reja, grave e vajzave të Shkodrës. U kam premtuar që do të jem afër çdo nevojë e kërkesë të qdonjërit. Do të punoj pareshtur, duke qenë gjithmonë në shërbimin të tyre, bashkë me ta dhe për ta. I premtoj e i garantoj përkrahje të pakushtëzuar nga ana ime. Si qytetare e Shkodrës, si bijtë e këtij qyteti, si e re, me dëshirën e madhe për të ecur përpara dhe për të bërë ndryshimin e nevojshëm e të detyrueshëm. Do bëj të pamundurën që si ligjvënës e re, të sjell risi në aspektin politik, por këtë le t'ia lëmë kohës.



Denoncimi te Berisha: Punonjësi i policisë më vrau burrin në '97

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një qytetareje dixhitale, e cila thotë se punonjësi i policisë në komisariatit e Dibërës, Eduard Kaba, i ka vrarë bashkëshortin në vitin 1997. Sipas qytetares dixhitale, sot ky punonjës policie emëron dhe heq nga puna punonjës në këtë komisariat. "Vrasës dhe dopio vrasës në komisariatit e Dibërës", shkruan z.Berisha. Më tej, ish-kryeministri publikon mesazhin e qytetarit dixhital. "Qytetarja dixhitale denoncon policin Eduard Kaba, që i vrau bashkëshortin në vitin 1997. Lexoni mesazhin e saj: U detyrova të shkruaj, pasi në vitin 1997 m'u vra burri dhe babai i djalit, Përparim Kucka, (Elmazi) nga shtetasi Eduard Fadil Kaba, i cili është punonjës policie në komisariatit e policisë, Dibër. Ky shtetas emëron dhe ç'meron çdo punonjës policie që ka komisariatit policisë Dibër. Ku do shkojmë ne që ky shtetas kriminel të bëjë vetingun pranë komisariatit të policisë Dibër", thuhet në mesazhin dërguar Berishës.



"Qeveria, Kuvendi dhe presidenti të dakordësohen me një amnisti të gjerë"

Propozimi i Shehut: Amnisti për kanabisin, të shpëtojnë fshatarët

"Të dënohen përfituesit, po shtojnë pasurinë"

Valentina Madani

Amnisti për kultivuesit e thjeshtë të kanabisit dhe dënim për përgjegjësit. Ky është propozimi i deputetit të PD-së, Tritan Shehu, i cili kërkon të amnistohen të gjithë fshatarët e thjeshtë, kultivues të kanabisit, duke bërë thirrje për ndëshkimin e përgjegjësve. Shehu i kërkon qeverisë, Kuvendit dhe presidentit të dakordësohen me një amnisti të gjerë për kultivuesit e thjeshtë të kanabisit, të dënuar apo jo deri tani. Në postimin e tij në "Facebook", deputeti i Partisë Demokratike thekson se drejtësia duhet të godasë stimulesit, organizatorët, protektorët dhe përfituesit e vërtetë të kësaj masakre masive droge e krimi. Sipas tij, burgjet janë mbushur me gjuhëzues, ndërsa kriminelët e përgjegjësit e vërtetë shtojnë pasurinë. "Thirrje për amnisti ndaj të gjithë fshatarëve të thjeshtë, kultivues të kanabisit, ndëshkim për përgjegjësit! Qeveria, Kuvendi e presidenti duhet të dakordësohen për një amnisti të



Deputeti i PD-së, Tritan Shehu

dhe 'haraçin', shprehet deputeti i PD-së. Sipas Tritan Shehut, kriminelët e përgjegjësit e vërtetë po shtojnë pasurinë. "Zyrtarët e shtetit, përgjegjës dhe të ndëshkuar për këtë veprimtarë edhe sipas ligjit 9559, neni 1, pika 3 i vitit 2006, nuk po pësojnë asgjë. Dje (pardje) në Tepelenë e Memaliaj, banorë të varfër, pa shpresë, të keqpërdorur edhe në çështjen 'kanabis', më ngritën pikërisht këto probleme. Asnjë masë për të dy kryetarët e bashkive përkatëse, Termet Peci e Durim Roshi, as për drejtorin e komisarariatit të Tepelenës, Emiliano Pashaj, ndërsa ai i Memaliajt, Argjent Shyti 'gradohet' në Dibër. I shtohet kësaj në qark edhe drejtuesi i sapoemëruar i komisarariatit të Përmetit, Feliks Hysi me të njëjtat probleme edhe kur drejtohte policinë në Laç. Padrejti dhe vetëm padrejtësi këto. Amnistia duhet realizuar për ata që u keqpërdorën dhe vazhdojnë të keqpërdoren. Drejtësia duhet të godasë stimulesit, organizatorët, protektorët e përfituesit e vërtetë të kësaj masakre masive droge e krimi!", shkruan Shehu.

NDËSHKIMI

Deputeti i PD-së thekson se drejtësia duhet të godasë stimulesit, organizatorët, protektorët dhe përfituesit e vërtetë të kësaj masakre masive droge e krimi. Sipas tij, burgjet janë mbushur me gjuhëzues, ndërsa kriminelët e përgjegjësit e vërtetë shtojnë pasurinë.

gjerë për të gjithë fshatarët, kultivues të thjeshtë të kanabisit, të dënuar apo jo deri më tash. Burgjet janë me

mijëra të tillë gjuhëzues, qindra janë në arrati, mijëra janë nën terror nga shtetëtarë, të cilëve u kanë paguar



"Java e Fëmijëve Jetimë", Meta vizitë në fshatin SOS

Në kuadrin e "Javës së Fëmijëve Jetimë", Presidenti i Republikës, Ilir Meta zhvilloi dje një vizitë në fshatin e fëmijëve SOS në Tiranë, si dhe në shtëpinë e foshnjës "Ana dhe Rozana". Në takimin dhe drekën e ngrohtë që pati me fëmijët dhe edukatorët e tyre në fshatin SOS, presidenti theksoi se prioriteti i tij do të jetë solidarizimi dhe përkrahja e fëmijëve pa kujdes prindëror. "Investimi për zhvillimin e shëndetshëm dhe edukimin arsimor të fëmijëve pa kujdes prindëror, me qëllim integrimin e tyre të denjë në shoqëri, është investim për të ardhmen e shoqërisë", theksoi presidenti. Kreu i shtetit përshëndeti veçanërisht rolin e madh që fshati SOS dhe donatorët e huaj të kësaj organizate kanë dhënë ndër vite në këtë drejtim.



Nishani vlerësohet si "Personalitet i shquar i Labërisë"

Si një nga shoqatat më Setëgjata, me aktivitetet si brenda dhe jashtë Shqipërisë, vlerësuara nga personalitete të shkencës, letërsisë, artit, kulturës, për kontributin saj "Shoqata Kulturore Atdhetare Labëria" nderoi me titullin "Personalitet i shquar i Labërisë" ish-Presidentin e Republikës, Bujar Nishani. Një nga tiparet që ish-kreu i shtetit përmendi si kryesor për gjatë 26 viteve të ekzistencës së kësaj shoqate është solidariteti. "Ne që vijmë në pozicione kaq të larta dhe kemi pushtet në duar, për fatin e keq e gëlltisim çdo mëngjes një filxhan të vogël helmi për shkak të pushtetit, fillojmë e besojmë tek diferencimi dhe distancimi me njerëzit e tjerë, tek dominimi ndaj të tjerëve edhe për shkak të privilegjit që të jep pushteti. Por ata që janë më me fat, e marrin edhe antidodën, dhe antidodën e marrin nga Perëndia.

"Ne shkurt BE me strategji të re drejt Ballkanit"

Integrimi, Mogherini: Viti 2018, vendimtar në rrugën drejt BE



Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Federica Mogherini dhe ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati

re të BE-së drejt Ballkanit dhe do ta përgatisim për muajin shkurt", shprehet Mogherini. Ajo përmend se të mërkurën drejtoi Këshillin e Asociimit dhe Stabilizimit me Shqipërinë, së bashku me ministrin e Jashtëm,

Ditmir Bushati. "Tirana ka nisur reforma të rëndësishme në drejtësi, në luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe trafikimit të drogës. Dhe për të gjitha çështjet kryesore të çështjeve të jashtme, Sh-

"Këto ditë e fundit pas vendimit historik për të nisur një bashkëpunim të përhershëm të strukturuar në mbrojtje, jemi përkushtuar për të punuar me partnerët tanë në Ballkan."

qipëria dhe Bashkimi Evropian janë në linjë me njëqind për qind. Për këto arsye, gjithashtu, kam konfirmuar vendosmërinë tonë për të ndjekur rrugën e integritimit evropian të Shqipërisë", tha zj. Mogherini

I "forti" Rinard Tata, foto në çadrën e PD-së

Prostitucioni, Xhafaj: Tri grupe kriminale në Shkodër, një e goditëm

Pas arrestimit të 7 per sonave në Shkodër ditën e shtunë, policia i ka marrë në pyetje, ndërsa ata kanë hedhur poshtë akuzat e ngritura për prostitucion. Rinard Tata, një ndër të arrestuarit, i njohur ndryshe edhe me emrin Frederik, është një emër i njohur për drejtësinë. Ai së bashku me Behar Bajrin është akuzuar për vrasjen e vëllezërve Artur e Osman Alibali, të ndodhur më 14 janar 1999. Tata kreu një dënim prej rreth 5 vitesh burg, ndërsa më pas u lirua për mungesë provash. Gjithashtu, Rinard Tata mësohet se ka

RINARD TATA

Tata mësohet se ka qenë militant i Partisë Demokratike dhe një prej mbështetësve të çadrës së protestës. Ai bashkë me dy nga vajzat që shfrytëzonte për prostitucion ka qenë pjesë e protestës së Partisë Demokratike përpara Kryeministrisë.

qenë militant i Partisë Demokratike dhe një prej mbështetësve të çadrës së protestës. Ai bashkë me dy nga vajzat që shfrytëzonte për prostitucion ka qenë pjesë e protestës së Partisë Demokratike përpara

Kryeministrisë. Edhe pse ishte i akuzuar për një sërë veprash penale, Tata u rreshtua krah kauzës PD-së për rrezimin e qeverisë "Rama". Rinard Tata mësohet se prej kohësh shfrytëzonte për ushtrim prostitu-

cioni 5 vajzat në lokalin e tij "TATA", në qytetin e Shkodrës. Policia sekuestroi edhe biznesin 3-katësh në pronësi të tij, ku realizohej veprimtaria kriminale, 2 automjete tip "Benz" dhe "Land Rover" në pronësi të tij. Gjithashtu, iu gjet dhe iu sekuestrua një armë zjarri pistoletë, 7 ora dore dhe një sasi e konsiderueshme bizhuterish e floriri të ndryshme, një laptop dhe 8 telefona celularë. Në lidhje me këtë ngjarje ka reaguar nëpërmjet një statusi në



I arrestuari, Rinard Tata

"Twitter" edhe ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, ku deklaroi se në qytetin verior janë dy grupe të tjera të identifikuar, që do të goditen. "Tjetër ndëshkim. Në kuadrin e operacionit 'Porca e Ligjit', një nga 3 grupet kriminale është iden-

tifikuar në qarkun Shkodër. Përkushtim dhe profesionalizëm, sukses i merituar i policisë Shkodër dhe Forcave operacionale. Bashkëpunim efikas me prokuroren e çështjes. Përgjegjime të gjithëve", deklaroi Fatmir Xhafaj.

Denoncimi i Aldrin Dalipit për tjetërsimin e 36 ha tokë ndihmoi në hetimin e prokurorisë

Abuzimi me pronat në Kavajë, burg për 10 nga 11 zyrtarët "Arrest shtëpie" për Çullhaj, ish-zyrtar i komunës Kryeviidh

Ina Allkanjari

Pas skandalit të zbuluar në Kavajë, ku zyrtarët të lartë të hipotekave ishin përfshirë në një rrjet të gjerë korrupsioni të tjetërsimit të tokës, Gjykata e Kavajës la në burg 10 nga 11 personat e akuzuar. Gjykata ka lënë në arrest shtëpie vetëm Dashnor Çullhajin, ish-zyrtar i komunës Kryeviidh të Kavajës, pasi ka probleme shëndetësore. Pas hekurave, deri në përfundim të hetimeve do të qëndrojnë Seid Çikalleshi, ish-kryeregjistrues i Hipotekës Kavajë; Fatos Kaja, ish-nënprefekt i Tiranës, drejtori aktual i ALUIZNI-t, Kavajë; Altin Çoba dhe 7 zyrtarët e ish-zyrtarët e tjerë të përfshirë në këtë ngjarje.

HETIMI

Hetimi i Prokurorisë së Kavajës, që zbuloi tjetërsimin e 36 hektarëve tokë shtetërore është ndihmuar edhe nga një kallëzim i bërë nga Aldrin Dalipi, kryetari i Këshillit Qarkut Tiranë. Dalipi zbuloi se në emër të tij ishin firmosur dhe vulosur dy dokumente dhe e kallëzoi rastin në prokurori në nëntor të 2016-ës. Verifikimet dhe më pas ekspertiza e prokurorisë, zbuluan se vula dhe firma e përdorur ishin false, ndërkohe që nuk kishte ekzistuar asnjë korrespondencë e mëparshme mes ZVRPP-së së



Spille

KALLËZIMI

Hetimi i prokurorisë së Kavajës është ndihmuar edhe nga një kallëzim i bërë nga Aldrin Dalipi, kryetari i Këshillit Qarkut Tiranë. Dalipi zbuloi se në emër të tij ishin firmosur dhe vulosur dy dokumente dhe e kallëzoi rastin në prokurori në nëntor 2016.

Kavajës dhe Këshillit të Qarkut në Tiranë për këtë çështje. Më pas Prokuroria e Kavajës zhvilloi hetime të gjera, duke verifikuar mbi dokumentet në ZVRPP Kavajë, në Bashkinë Rrogozhinë, si edhe praktikant administrativ të ish-komunës Kryeviidh, e cila mbulonte zonën e

plazhit të Spillesë. Mësohet se Seid Çikalleshi, ish-kryeregjistrues i Hipotekës së Kavajës, në bashkëpunim me disa zyrtarë të institucionit të tij si edhe me mbështetjen e ish-zyrtarëve të komunës Kryeviidh kanë ndryshuar zërin kadastral nga "ranishte" në "tokë arë". Në bazë të ligjit

VENDIMI I GJYKATËS SË KAVAJËS

1. Seid Çikalleshi, ish-kryeregjistrues i Hipotekës Kavajë - "Arrest në burg".
2. Dritan Kazazi, hartograf, ZVRPP, Kavajë - "Arrest në burg".
3. Andi Gjeçi, jurist, ZVRPP, Kavajë - "Arrest në burg".
4. Fatos Kaja, ish-nënprefekt i qarkut Tiranë - "Arrest në burg".
5. Ilir Kaja, zyrtar i Njësisë Administrative Kryeviidh - "Arrest në burg".
6. Nezir Leçini, ish-shëf i Zyrës së Kadastrës, Kavajë - "Arrest në burg".
7. Agron Xhelezi, ish-kryetar i Ndarjes së Tokave, Kavajë - "Arrest në burg".
8. Enver Duqj, ish-drejtor i Mbrojtjes së Tokës, Kavajë - "Arrest në burg".
9. Altin Çoba, drejtor i ALUIZNI-t, Kavajë - "Arrest në burg".
10. Behgjet Pjeçi, ish-kryetar i komunës Kryeviidh, Kavajë - "Arrest në burg".
11. Dashnor Çullaj, ish-zyrtar i komunës Kryeviidh, Kavajë - "Arrest shtëpie".

TJETËRSIMI

Seid Çikalleshi, ish-kryeregjistrues i Hipotekës së Kavajës, në bashkëpunim me disa zyrtarë të institucionit të tij si edhe me mbështetjen e ish-zyrtarëve të komunës Kryeviidh, kanë ndryshuar zërin kadastral nga "ranishte" në "tokë arë".

"Për tokën", toka ranishte nuk ishte pjesë e fondit të ndarjes së tokave. Nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve, sipërfaqen prej 36 hektarë bregdet, zyrtarët lokalë e kanë shënuar në zërin kadastral "tokë arë". Më pas, këtë tokë ua kanë shpërndarë familjeve të ndryshme, të

cilat kanë pasur qëllim tjetërsimin e menjëhershëm të saj nëpërmjet shitjes. E vënë në dijeni të procesit të shpejtë të tjetërsimit, Prokuroria e Kavajës ndërhyri në korrik 2017, duke e vendosur nën sekuestro sipërfaqen e ranishtes për të penguar përkeqësimin e situatës në terren.



Fatos Kaja

PERSONAT QË PËRFITUAN

Dokumentet e hetimit tregojnë se toka e tjetërsuara fillimisht në emër të banorëve të zonës u kaluan përmes kontratave të shitjes apo të dhurimit të të afërmeve të pushtetarëve lokalë të Kavajës, ku kryeson rrethi familjar i ish-kryetarit të bashkisë, Elvis Rroshti; kryetarit të PS në Kavajë, Gentian Daja; nënprefektit të Tiranës, Fatos Kaja; ish-shëf të Zyrës së Kadastrës në Kavajë, Nezir Leçini si dhe të afërmit të gjyqtarit Luan Lusha.

NOFTIM PER SHITJE

Ne Zyrën e Permbarruesit Gjyqësor Arjan Palla me adresë Blv.Zogu i I-re, Pall.Agimi, H-2. K-3. Ap.-5-Tiranë me dt. 20.11.2017 ora 16.00 zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë me nr. 1/197 +3-26, vol8, fq.48, zk 8260, lloji i pasurisë apartament me sip. 73 m2 ndodhur në Tiranë, rregjistruar në pronësi të Fazile Stafa. Cmimi me të cilin fillon shitja është 28405,2 Euro.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarrues Enuar Merko me adresë Rr e Bogdaneve, Pall 15, Kati 2, Tiranë, Njesia 10 njofton se me date 01.12.2017 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i III për shitjen e pasurisë të pakujtimit Apartament me sipërfaqe totale 61.5 m², me numër pasurie 90/1994+2, volumni 20, faqe 164, zona kadastrale 1791 me adresë Golem, Kavajë në pronësi të Z.Mnir Anil Rruqa dhe Znj.Servete Behexhet Rruqa me vlerë fillestare në ankand 12.390 (Dymbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) EURO dhe Apartament me sipërfaqe totale 56.5 m², me numër pasurie 90/1994+1, volumni 20, faqe 163, zona kadastrale 1791 me adresë Golem, Kavajë në pronësi të Z.Mnir Anil Rruqa dhe Znj.Servete Behexhet Rruqa me vlerë fillestare në ankand 11.391 (Njëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarrues Enuar Merko me adresë Rr e Bogdaneve, Pall 15, Kati 2, Tiranë, Njesia 10 njofton se me date 28.11.2017 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i I për shitjen e pasurisë të paluejshme Apartament me sipërfaqe totale 65 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr pasurie 1/154+1-4, Vol.7, Fq.247, ZK.8350 në pronësi të Z.Lirim Petref Koçaj, Petref Hito Koçaj, Fato Mejdo Koçaj, Altin Petref Koçaj, Agron Petref Koçaj dhe Eteva Xheladin Koçaj me vlerë fillestare në ankand 39.000 (Tridhjetë e nëntë mijë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, email enuar.merko@gmail.com

Vazhdojnë hetimet për identifikimin dhe kapjen e autorëve

Grabiten 4600 euro në teatrin e Elbasanit, financierja: Janë të miat

ELBASAN

Teatri "Skampa" në qytetin e Elbasanit ka rënë mbrëmjen e së shtunës pre e grabitësve. Mësohet se vjedhja është konstatuar paraditen e djeshme dhe të parët që njoftuan policinë ishin punëtorët, të cilët gjetën kasafortën hapur. Blutë e Elbasanit njoftojnë se rreth orës 11:00 të së dielës, salla operative u njoftua për një grabitje në teatrin "Skampa" në lagjen "Luigj Gurakuqi". Forcat policore shkuan menjëherë në vendngjarje, ku konstatuar se gjatë natës, persona të paidentifikuar kanë thyer derën e pasme të teatrit duke grabitur një shumë të konsiderueshme parash, që gjendej në kasafortë. Nga veprimet e para hetimore dhe bazuar në deklaratën e financieres së këtij institucioni, rezultojnë se janë vjedhur rreth 4500 euro në kasafortën e zyrës së financieres së këtij institucioni dhe se kjo shumë parash ishte e saja person-



Teatri "Skampa" i Elbasanit

ale, pasi ajo i kishte lënë paratë për ruajtje në zyrën e saj. Po në vijim të veprimeve në vendngjarje si dhe nga deklaratimet e personave përgjegjës të zyrave rezultojnë

se persona të paidentifikuar dyshohet të kenë hyrë nga dera e pasme e teatrit "Skampa", por nuk kanë vjedhur asnjë send në pronësi të institucionit, por thjesht kanë



Grabitja

FINANCIERJA

Nga veprimet e para hetimore dhe bazuar në deklaratën e financieres rezultojnë se janë vjedhur rreth 4500 euro në kasafortën e zyrës së financieres së teatrit "Skampa" dhe se kjo shumë parash ishte e personale e financieres, pasi i kishte lënë për t'i ruajtur në zyrën e saj.

hapur dyert e zyrave. Financierja është shprehur në polici se shumën ia kishte dërguar ditën e djeshme i vëllai nga Gjermania, ndërsa i kishte lënë në kasafortë për siguri, pasi bankat janë mbyllur në fundjavë. Financierja ka deklaruar se të ardhurat e teatrit nga biletat

nuk mbahen në kasafortë, por dërgohen menjëherë në bankë. Grupi hetimor po vijon hetimet për sqarimin e rrethanave të faktit të lënies së kësaj shume në ambientet e zyrës së financieres. Shërbimet e policisë po punojnë për identifikimin dhe kapjen e autorëve.



Gjendet një trup pa kokë në Itali, dyshohet i avokatit Besnik Muço

Mbetet ende mister zhdukja e avokatit shqiptar Besnik Muço. Dy ditë më parë në brigjet e Leçës në Itali u gjet një trup i pajetë. Sipas mediave italiane mësohet se dyshimet janë për avokatit 54-vjeçar, i cili humbi gjurmë më 2 nëntor, teksa po udhëtonte me tragetin e linjës Durrës-Bari. Kufoma e gjetur pranë shkëmbit të Castros në zonë e Pulias, sipas ekspertizës italiane ishte e paidentifikueshme për shkak të dëmtimeve të shumta nga dallgët. Sipas gazetave italiane, trupi i pajetë ishte totaisht i zhveshur dhe i mungonte koka. Prokuroria e Maçeratas ka kërkuar analizën e ADN-së për të bërë të mundur identifikimin e kufomës. Dyshimet nga pala italiane se trupi i pajetë i përket avokatit shqiptar lidhen me faktin se nga policia fqinje nuk rezultojnë asnjë shtetas i zhdukur. Sakaq, familjarët e avokatit thonë se nuk kanë marrë njoftim zyrtar nga autoritetet italiane. Ata hedhin poshtë mundësinë se kufoma mund të jetë i familjarit të tyre.



Gjendet e vdekur në banesë vajza e aktorit shqiptar, shkak mbidoza

KOSOVË: Vajza e aktorit nga Kosova, Çun Lajçi, Bubulina Lajçi është gjetur e vdekur ditën e djeshme në banesën e saj në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Vajza 34-vjeçare është gjetur nga të afërmit pa shenja jete. Dyshimet e para të policisë janë se Bubulina Lajçi ka vdekur për shkak të mbidozës nga lëndët narkotike. Policia e Kosovës e ka konfirmuar lajmin për vdekjen e një vajze në këtë lagje, por pa dhënë detaje të tjera. Rasti nga policia është cilësuar si vdekje e dyshimtë dhe trupi është dërguar për ekspertizën mjeko-ligjore.

"The Sun": Selami Çokaj udhëheq dy biznese në Britaninë e Madhe

I dënua për vrasje në Shqipëri, jeton si biznesmen në Angli

Vrasësi shqiptar, Selami Çokaj, i cili i shpëtoi dënimit me 20 vjet burg nga një vendim i Gjykatës së Lartë, u arratis nga atdheu drejt Britanisë së Madhe. 43-vjeçari Çokaj gjendet në Angli dhe mësohet se drejton një lavazh makinash në Leicester. Çokaj u dëbua nga Britania e Madhe në vitin 2009, pasi zyrtarët zbuluan se ai ishte arratisur nga burgu në Shqipëri. Ai ishte dënua për vrasjen e një njeriu në vitin 1994, por u arratis pas 3 vjetësh burg gjatë trazirave të vitit 1997. Tani jeton i lirë falë vendimit të Gjykatës së Lartë, duke i dhënë mundësinë të rikthehet në Angli. Gazeta britanike "The Sun" njofton se Selami Çokaj udhëheq dy biznese në Britaninë e madhe. Deputeti Tory Philip Davies, i pyetur nga "The Sun" tha se është totalisht e papranueshme që Çokaj kishte arritur të kthehej në Angli, pavarësisht vëzhgimit të forave kufitare. "Kjo tregon se kontrollët tona kufitare janë të dobëta dhe më lind pyetja se sa kriminelë të huaj kanë hyrë në vend", tha Davies.



SELAMI ÇOKAJ

43-vjeçari Çokaj u dënua për therjen e një njeriu në vitin 1994, por u arratis tri vite më pas për në Britani. Tashmë ai jeton me familjen e tij në një shtëpi në Oadby, Leicestershire. Çokaj në 2009 u arratis nga burgu në Shqipëri, pas dënimit që kishte marrë në 1994. Është e paqartë se si Çokaj arriti të kalojë kufirin. Ai ishte në listën e më të kërkuarve të Interpolit, kur u zbulua që jetonte në Mansfield, Nottinghamshire, në vitin 2006.

Sipas tij, është e pajustificueshme prezenca e 43-vjeçarit në Angli dhe se duhet depërtuar menjëherë në Shqipëri.

NGJARJA

Çokaj ishte në listën e më të kërkuarve të Interpolit, kur u zbulua që jetonte në Mansfield, Nottingham-

shire, në vitin 2006. Më pas autoritetet e huaja zbuluan se 43-vjeçari ishte rikthyer në Angli dhe drejtoi një lavazh, duke fituar 40 mijë

paund në vit. Ai u arrestua dy herë, por më vonë u lirua me kusht nga gjykatësit. Çokaj kërkoi më pas azil në vitin 2015 duke pretenduar se do të ishte në rrezik, nëse do të kthehej në vendin e tij, kërkesë që i zgjati qëndrimin 3 vjet në Angli. Mësohet se momentalisht Çokaj, i cili më parë pretendonte se emrin e tij të vërtetë ishte Valtron Gashi, është drejtor i dy firmave aktive, "Senture" dhe "Sela & Sons Consulting". Çokaj dhe familja e tij behohet se paguan një qira prej 1500 paund në muaj, kanë një makinë tip "Volvo XC90 D5" me vlerën 52000 paund dhe një makinë tip "VW Beetle". Kur njëri prej gazetarëve investues të "The Sun" u afrua afër lavazhit, Çoka i tha "largohu". Më pas ka debatuar për disa minuta duke i thënë: "Nuk kam asgjë për të thënë, largohu". Ndërsa, Zyra Kombëtare e Emigracionit ka reaguar duke thënë se janë të vetëdijshëm për Selami Çokaj dhe aktualisht po kërkohet deportimi i tij në Shqipëri.

PENSIONET E USHTARAKËVE VENDIMI GJYQËSOR

Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesëpadinë e shoqatave. Kush preket nga vendimi

Rillogariten pensionet për 20 mijë ushtarakë në lirim

Avokati Asllanaj: Shkelje e rëndë e Kushtetutës

Voltiza Duro

Rreth 20 mijë ushtarakë në mbarë vendin do të preken nga ulja e pensioneve, pasi Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesëpadinë e tyre dhe la në fuqi vendimin unifikues të kolegjeve të Gjykatës së Lartë. Që nga viti 1991 e deri më sot, të gjithë ushtarakëve që kanë dalë në rezervë në bazë të statusit të ushtarakëve të vitit 1991 u takonte të merrnin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, pagesë kalimtare dhe pension suplementar. Ky vendim prek edhe të gjithë ata ushtarakë në rezervë që kanë fituar gjyqin apo janë ende në proces, të cilët do të detyrohen t'i kthejnë shtetit shuma që variojnë nga 2 milionë deri në 37 milionë lekë të vjetër. Në një prononcim ekskluziv për "Gazeta Shqiptare, avokati i shoqatave të ushtarakëve, Bashkim Asllanaj tha se vendimi i marrë nga Gjykata Kushtetuese është antikushtetues, pasi është në kundërshti me vetë ligjin e Republikës së Shqipërisë. Sipas tij, nga vendimi unifikues preken ata ushtarakë që kanë fituar gjyqet dhe tashmë kthehen në debitorë. "Ditën e enjte më njoftuan për të më bërë me dije vendimin që u mor mbi fatin e ushtarakëve. Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e shoqatave të ushtarakëve dhe la në fuqi vendimin unifikues të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë. Arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese për këtë vendim është që shoqatat që bënë padinë nuk kanë legjitimitet për të kundërshtuar këtë vendim. Kjo është një shkelje e rëndë e Kushtetutës, pasi cenon të drejtat e gjithë ushtarakëve dhe policëve, të përcaktuara në ligj", tha Asllanaj. Sipas tij, nga ky vendim preken rreth 20 mijë ushtarakë, sepse nuk bëhet fjalë vetëm për ata ushtarakë që përfitojnë sot, por të gjithë ata që i kanë fituar të drejtat me ligjet e mëparshme. Avokati



Foto ilustruese



Thoma Konduri

THOMA KONDURI: DUHET TË KTHEJME MBRAPSHT 2-37 MLN LEKË
Kryetari i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, Thoma Konduri tregoi dje për "Gazeta Shqiptare" se vendimi i marrë nga Gjykata Kushtetuese është pritur negativisht nga ushtarakët. "Gjykata Kushtetuese nuk e mori parasysh kërkesën tonë. Normalisht që këtë vendim e pritëm negativisht, duke ditur çfarë gjykatash kemi e si funksionojnë ato. Nëse qeveria nuk u vë 'frenat' Sigurimeve Shoqërore, këta të fundit do e hapin çështjen në bazë të vendimit të Gjykatës së Lartë. Për pasojë, ushtarakët do të jenë të detyruar të kthejnë paratë mbrapsht, në vlerën që varion 2 deri në 37 milionë lekë të vjetër", - shprehet i revoltuar kreu i SHKURSH-it.

thekson se pas kësaj, ushtarakët do të pësojnë një ulje të ndjeshme, drastike të pen-

sioneve që kanë përfiturur çka do të ndikojë drejtpërdrejt në përqendrimin e gjendjes ekonomike të kësaj kategorie dhe familjeve të tyre në shkallë vendi. "Ky është një vendim unifikues, pra ka shtrirë efektin e tij në një kategori me një numër të madh individësh që preken. Pra, janë cenuar të drejtat aktuale dhe të së kaluarës, duke i dhënë fuqi këtij vendimi. Por, ne kemi ndërmend që çështjen ta çojmë deri në Gjykatën e Strasburgut", - u shpreh avokati.

REGAIMET

Kryetari i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, Thoma Konduri tregoi dje për "Gazeta Shqiptare" se vendimi i marrë nga Gjykata Kushtetuese është pritur negativisht nga ushtarakët. "Gjykata Kushtetuese nuk e mori parasysh kërkesën tonë. Normalisht që këtë vendim e pritëm negativisht, duke ditur çfarë gjykatash kemi e si funksionojnë ato. Vetingu është i domosdoshëm në këtë sektor, duke nisur që nga Gjykata Kushtetuese, e cila bashkë me Gjykatën e Lartë cenoi rëndë të drejtat tona", - shprehet Konduri. Ai më tej tregon se të gjithë ushtarakët e prekur do të organizohen dhe do e dërgojnë çështjen deri në Gjykatën e Strasburgut. "Nëse qeveria nuk u vë 'frenat' Sigurimeve Shoqërore, këta të fundit do e hapin çështjen në bazë të vendimit të Gjykatës së

SKEMA

- a) 50% e pagës referuese mbi të cilën është dërdhur kontributi.
- b) Për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi 12 vjet për burrat, masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese.
- c) Masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi.

Lartë. Për pasojë, ushtarakët do të jenë të detyruar të kthejnë paratë mbrapsht, në vlerën që varion 2 deri në 37 milionë lekë të vjetër", - shprehet i revoltuar kreu i SHKURSH-it.

SKEMA E PËRLLGARITJES

"Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se: rillogaritja e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas nenit 29 i Ligjit nr.10142/2009, do të bëhet sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj, edhe në situatën kur kjo rillogaritje u masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të njohur dhe aktualit më parë", - citohet në vendimin unifikues të Kolegjeve të

20

MIJË USHTARAKË, ULJE PENSIONESH

"Nga ky vendim mbi 20 mijë ushtarakë do të preken nga ulja e ndjeshme, drastike e pensioneve. Ky është një vendim unifikues, që ka shtrirë efektin e tij në një kategori me një numër të madh individësh që preken. Pra, janë cenuar të drejtat aktuale dhe të së kaluarës, duke i dhënë fuqi këtij vendimi. Por, ne kemi ndërmend që çështjen ta çojmë deri në Gjykatën e Strasburgut", - u shpreh avokati.

Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Skema parashikon që 50% e pagës referuese mbi të cilën është dërdhur kontributi dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi 12 vjet për burrat, masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese, me kushtin që masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë, Shoqata e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë si dhe Shoqata e Organizatës së Punojnëve të Policisë së Shtetit në Lirim kanë kundërshtuar fuqishëm vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, duke kërkuar pezullimin në Gjykatën Kushtetuese. Seanca e zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese mbi këtë çështje nuk e kanë lejuar praninë e palëve, duke përfshirë këtu edhe vetë avokatin e shoqatave të ushtarakëve, Bashkim Asllanaj.

SHKURT

Gjohë për 12 gurore, Klosi: Do të merren masa

Pas inspektimit të kryer në terren ku ishte i pranishëm edhe ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, 12 gurore janë gjobitur e pezulluar pasi shfrytëzonin gurin dekorativ në Malin e Tomorrit. Sipas Klosit, dokumentacioni i këtyre guroreve do të verifikohet me imtësi dhe në bazë të shkeljeve, do të merren masa deri në ndjekje penale. "Janë evidentuar nga inspektorati plot 12 gurore vetëm në këtë zonë, të cilat janë krejtësisht jashtë çdo parametri mjedisor dhe shfrytëzojnë këto leje minierare në mënyrë krejtësisht të paligjshme. Prandaj Inspektorati i Mjedisit do të marrë masa duke i gjobitur ato që sot, duke kërkuar revokimin e lejeve mjedisore për të 12 subjektet dhe po ashtu duke parë të gjitha mundësitë që të 12 subjektet të kalojnë edhe për ndjekje penale", tha ministri. Më tej, ai paralajmëroi se nuk do të tolerohet më asnjë biznes që shkel ligjin dhe e konsideroi të pafalshëm dëmin e krijuar në një nga malet më të vizituara në mbarë vendin. Klosi theksoi se një nga objektivat kryesore brenda aksionit të 6 muajve, është lufta kundër guroreve që shkelin lejet mjedisore.

Bashkia e Tiranës mbjell 100 pemë të tjera në Farkë

Në kuadër të projektit të Pylit Orbital, Bashkia e Tiranës dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka vijuar me mbjelljen e 100 pemëve të tjera në Farkë. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, falënderoi të gjithë ata që iu bashkuar kësaj nisme dhe theksoi se kjo është mënyra më e mirë për t'i lënë gjeneratës së ardhshme një qytet më të mirë dhe më të shëndetshëm. "Besoj se paja më e mirë që i lëmë qytetit, pavarësisht nga mosha jonë, është një qytet më i gjelbër, me më shumë pemë, me më shumë oksigjen. Më vjen mirë që ky kontribut shkon për të pasuruar parkun e Farkës", shtoi kryebashkiaku Veliaj. Ai nënvizoi se falë vëmendjes së kushtuar në këto dy vite në këtë zonë, Parku i Liqenit të Farkës po merr formë të plotë, ku po krijohet edhe një hapësirë me pemë dhe bimësi të tjera. Më tej, Veliaj u shpreh se krahas mundësive rekreative që ofron Parku i Liqenit të Farkës, tashmë falë këtyre investimeve po përfitojnë edhe banorët e zonës nëpërmjet rritjes së vlerës së pronës. Deri më tani në liqenin e Farkës janë mbjellë 3200 fidanë të drurëve dekorativë, si dhe 2000 rrënjë fidanë ulliri e pyjorë në territore publike.

DIKTATURA KOMUNISTE DENIMET

EKSKLUZIVE/ Zbulohet dokumenti i Sigurimit të Shtetit i '70, dërguar Hysni Kapos për dënimin e Raif Elezit, Bajram e Avdi Gjanës nga Kukësi, Izet Dervishit dhe Daut Gumenit nga Tepelena, si dhe Kujtim e Durim Veledit nga Tirana

Dokumenti sekret: Si u dënua Daut Gumeni me të vëllanë dhe kushëririn, të akuzuar për akte terrori

Kryetari i Degës së V, Kapllan Sako: Kthjem në Jugosllavi 12 kosovarë dhe 3 shtetas grekë i përcollëm për në Gjermaninë Perëndimore

Dashnor Kaloçi

Gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist të Enver Hoxhës, që nga viti 1945 e deri në vitin 1990-të, kur nisi dhe Lëvizja Studentore, në varësi të konjunkturave e ngjarjeve politike që ndodhnin në arenën ndërkombëtare, Sigurimi i Shtetit nën udhëheqjen e PPSH-së ndërmerre "zbulime", arrestime dhe goditje "grupesh armiqësore", të cilat pothuaj në më të shumtën e rasteve i inskenonte vetë, duke i paraqitur ato si mjaft të rrezikshme. Dhe si rezultat janë dënuar me ekzekutim, vite të gjata burgimi dhe internuar me qindra e qindra persona. Në këtë kontekst, për gati katër dekada me radhë janë "zbuluar" dhe goditur mjaft të ashtuquajtura "grupe armiqësore" si psh., grupi i sabotatorëve të Kënetës së Maliqit dhe grupi i deputetëve, në 1946-'47, grupi i Abedin Shehut, Shyqëri Kellëzit etj., në vitin 1950, grupi i Dalit Ndreut, Liri Gegës e Petro Bullatit si dhe grupi i Konferencës së Tiranës në 1956-ën (me Iljaz Ahmetin, Vehip Demin, Vandush Vinçanin etj.), grupi i Teme Sejkos në 1960-ën, grupi i Stavri dhe Thoma Rafaellit në 1963-in (ku bënë pjesë edhe Trifon Xhagjika, Robert Vullkani etj.), grupi i ushtarakëve që kundërshtuan heqjen e gradave në Ushtri në 1967-ën (me generalmajor Halim Xhelon, kolonel, Dilaver Radëshi etj.), grupi i Festivalit të 11 të Këngës në Radio-Televizion në 1972-in (me Mihallaq Luarasin, Edi Luarasin, Minush Jeron, Justina Aliajn, Bujar Kapexhiun etj.), grupi i Todi Lubonjës e Fadil Paçramit në art-kulturë në 1974-ën, grupi puçist në Ushtri në 1974-ën, me Beqir Balukun, Petrit Dumen, Hito Çakon etj., grupi i arsimit në 1974-'75 me Thoma Deljanën, Mantho Balën, Hasan Dumën, etj., grupi i lopëve të Baldushkut në 1975-ën (Ndue Marashi, Rifat Daja, Agim Akçani etj.), grupi i sabotatorëve në ekonomi në 1975-'76-ën, me Abdyl Këllezin, Koço Theodhosin, Kiço Ngjelen, Vasil Katin etj., grupi i naftës në 1976-'77 me Koço Plakun, Lipe Nashin, Milto Gjokopullin etj.,



"Grupi i Naftës", Koço Plaku

Grupi i Edip Ohrit, Sabri Pilkatit, Ali Kubati etj. në 1980-ën, grupi i Mehmet Shehut, Kadri Hazbiut, Feçorr Shehut etj. në 1981-'82-in. Grupi i kosovarëve në 1982-in (Namik Luca, Selim Kelmendi, Estref Kelmendi etj.), për të përfunduar në vitin 1986-'87-ën me grupin e Medi Çelikut, Bujar Jazexhiut etj. E gjitha kjo bëhej me qëllimin

kyesor që ngjarjet apo konjunkturave politike që ndodhnin kryesisht në arenën ndërkombëtare dhe në Shqipëri të parandaloheshin dhe të mos kishin ndikime e impaktin më të vogël tek të tjerët. Në këtë kontekst janë bërë arrestime, goditje dhe dënime edhe në vitin 1970-të, me të ashtuquajturin grupi terrorist i Kuksit (me Raif Elezin, Avdi

dhe Bajram Gjanën etj.) dhe ai i Tepelenës (me Dervish, Izet dhe Daut Gumenin), për të cilat veç të tjerash bën fjalë edhe ky dokumenti arkivor që po publikojmë më poshtë në këtë shkrim ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare". Ish-kryetari i Degës së V të Sigurimit të Shtetit, me anë të një buletini "Tepër Sekret" informon udhëheqjen e lartë të PPSH dhe personalisht Hysni Kapon për zbulimet, arrestimet dhe dënimet që janë bërë në vitin 1970.

**REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË SEKRET
MINISTRIA E PUNËVË TË BRENDSHMË EKZEMPLAR NR. 1 BREJTORIA E PARË TIRANË
MË 12.6.1970
NR. 2415**

BULETINI Nr.1

- Në muajin dhjetor 1969 përfunduan hetimet në drejtim të grupit armiqësor të rrethit Kukës, që përbëhej nga 11 të pandehur. Në muajin mars 1970, çështja u gjykua nga gjykata e rrethit Kukës, e cila në seancë të hapur gjyqësore dhe me pjesëmarrjen e masave punonjëse,



demaskoi veprimtarinë e tyre armiqësore, duke dënua të pandehurit: Raif Elezi me 15 vjet heqje lirie, Bajram Gjanën me 13 vjet, Avdi Gjanën me 9 vjet, ndërsa të tjerët me afate të shkurtra burgimi. Gjykimi provoi plotësisht se të pandehurit në bashkëpunim me njëri-tjetrin kishin zhvilluar agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor, duke diskutuar edhe për organizimin e një kryengritje të armatosur në rrethin e Kukësit, ishin përgatitur për të kryer akte terrori kundër Udhëheqjes së Partisë dhe të Shtetit e mbanin armë zjarri e lëndë eksplozive.

-Në këtë proces u implikuan 27 persona ndaj të cilëve, paralelisht me hetimin, mbasi u bë diferencimi, u bë këshillimi, u pyetën si dëshmitarë, u demaskuan dhe masa të tjera operative.

-Në muajin prill 1970, Gjykata Popullore e rrethit të Tepelenës dënoi me 25 vjet heqje lirie të pandehurin Izet Gumenin nga katundi Gusmar, për arsye se në dhjetor 1945, në bashkëpunim me bandën e kriminelëve Lahu Nuro, Izet Vrazhdo dhe Ahmet Kuka kanë marrë pjesë në kryerjen e aktit të terrorit, duke vrarë Sekretarin e Partisë të Kurveleshit, Selman Lamen.

-Po kjo gjykatë dënoi me 15 dhe 8 vjet heqje lirie të pandehurit e tjerë. Dervish dhe Daut Gumenin, të cilët në bashkëpunim me të pandehurin Izet zhvilluan agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor dhe se nuk kishin treguar aktin e terrorit që kishte kryer ky i fundit, për të cilin ishin vënë në dijeni kohë më parë.

-Një nga dëshmitarët e akuzës për aktin e terrorit të kryer nga i pandehuri Izet Gumeni ishte dhe i riadhesuari Mustafa Korocka, i cili gjithashtu u dënua nga Gjykata e rrethit të Vlorës me 25 vjet heqje lirie për tradhti ndaj atdheut dhe për një vrasje që kishte kryer në vitin 1948 në kohën e arratisjes së tij.

-Në muajin mars 1970 u dënuan nga Gjykata e rrethit të Tiranës për krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor, të përvetësimit të pasurisë socialiste dhe kontrabandës, grupi prej pesë vetash i përbërë nga Dhimitër Heqimi, Sofokli Heqimi, ➔



Daut Gumeni



Raif Elezi



Gjyqi i Kadri Hazbiut

← Gjergji Mole, Sami Gjyzeli dhe Shaqir Vorpsi.

-Dhimitër Heqimi, Gjergji Mole dhe Shaqir Vorpsi që ishin edhe më kryesorët në këtë grup, u dënuan me 8, 10, e 9 vjet ndërsa të tjerët me afate më të shkurtra privimi lirie.

-Nga 25 personat e implikuar në këtë proces për krime të ndryshme, duke pasur parasysh përbërjen politike të secilit dhe shkallën e kompromentimit në krim, një pjesë u pyetën me cilësinë e dëshmitarit, ndërsa për të tjerët u morën masa këshillimi, demaskimi


dhe masa të tjera operative.

- Në muajin prill të vitit 1970, u dënuan nga Gjykata Popullore e rrethit të Tiranës, për përvetësimin e pasurisë socialiste në përpjesëtime të mëdha, të kontrabandës së cilësuar dhe të shkeljes së dispozitave në lidhje me vepërimet e valutës dhe të arit, grupi prej 13 vetash i përbërë prej Haxhire dhe Zyber Zhegu, Mustafa Kallçiu, Lumturi Kaçini etj.

-Mustafa Kallçiu, Haxhire Zhegu dhe Lumturi Kaçini që ishin dhe kryesorët në këtë grup, u



Bajram Gjana



Avdi Gjana

dënuan respektivisht me nga 15, 11 dhe 9 vjet heqje lirie, ndërsa të tjerët me afate më të shkurtra burgimi.

- Gjykimi i të pandehurve u bë në N.T.L.F.Z. Tiranë, ku këta kishin kryer krimet dhe zhvillimi i gjyqit luajti një rol mjaft edukativ me masat.

-Në drejtim të 20 personave të implikuar në këtë proces për krime të ndryshme, u morën masa këshillimi, demaskimi dhe masa të tjera operative.

-Të pandehurit, Kujtim dhe Durim Veleci që në bashkëpunim me njëri-tjetrin zhvillonin agjitacion e propagandë edhe në formën e bisedave për arratisje jashtë shtetit e të dëshirës për të kryer akte terrori në drejtim të udhëheqjes së partisë e të shtetit si dhe për armën që mbanin pa leje, u gjykan dhe u dënuan me nga 10 dhe 3 vjet heqje lirie.

-Kohët e fundit përfunduan hetimet kundër të pandehurve Pashko dhe Gjin Mrruku, kushërinj të parë nga rrethi i Mirditës. Të pandehurit akuzohen se në vitin 1951, në bashkëpunim me njëri-tjetrin për motive të dobëta dhe nën ndikimin e dajës së tyre, kriminelit Marka Doda, arratisur jashtë shtetit, kanë vrarë të pandehurit Pashko, në rrethit e Matit.

-Më datën 30 maj 1970, organet e punëve të brendshme të rrethit të Korçës kapën në flagrancë duke tentuar për t'u arratisur jashtë shtetit në Greqi, të rinjtë 18- vjeçarë, Edmond Naumi, Ilija Stojani dhe Kastriot Peçi, që të tre nga qyteti i Tiranës.

-Hetimet në drejtim të të pandehurve vazhdojnë me qëllim që të zbulohen shkaqet që i çuan këtë të rinj në kryerjen e këtij krimi.

-I dënuari Niko Pandi Sholla, më datën 21 maj 1970 mundi të arratisë nga kampi i riedukimit Bulgizë, më datën 29 maj 1970, mbasi u plagos rëndë në të dyja këmbët nga populli dhe forcat që ishin nënë në ndjekje të tij, u kap prej tyre në sektorin Suç të rrethit të Matit dhe është shtruar në spital për t'u mjekuar.




-Gjatë tremujorit të dytë të vitit 1970, me sanksionim të Prokurorisë së Përgjithshme, në rrethe të ndryshme, për krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor janë arrestuar gjithsej 16 persona, nga të cilët 6 janë të shtresës së pasur dhe kulakë. Ndërmjet këtyre është dhe kulaku Petrit Allamani nga rrethi i Matit, i cili në deponimet e deritanishme për krimin e agjitacionit e propagandës, implikon rreth 15 persona me përbërje të keqe dhe kulakë.

-Paralelisht në hetimin në drejtim të këtyre implikimeve janë marrë masat e nevojshme për verifikim.

-Gjatë këtij 5-mujori nëpërmjet komisionit të incidenteve kufitare u kthen në Jugosllavi 12 kosovarë të ardhur ilegalisht në vendin tonë me pretekst për të vazhduar shkollën. Thëksojmë se me ta është bërë një punë sqaruese e bindëse për krimin (jo operative) dhe si rezultat i kësaj, ata nuk kanë pasur kundërshtim për t'u kthyer në Jugosllavi.

-Po kështu, më datën 26 maj 1970, organet tona, me kërkesën e tyre dhe meqenëse paraqitimin dyshimor, nxorën jashtë kufirit shtetëror, duke i nisur për në Gjermaninë Perëndimore, shtetasit grekë, Paskal Nikolla Sokolaciq dhe Jorgo Dhimitër Jogridhis.

KRYETAR I DEGËS SË V (KAPLLAN SAKO)



Të prekur nga tragjedia, rreth 30 familje emigrantësh shqiptarë

Përmbytjet në Greqi, gjendet trupi 29-vjeçarit shqiptar

Petro Koleci rezultonte i zhdukur prej disa ditësh

Mijëra njerëz humbën mundin e një jete të tërë në tragjedinë e ndodhur në Mandra të Athinës. Numri i viktimave nga përmbytjet masive që goditën Greqinë ka shkuar në 19, mes tyre edhe 29-vjeçari shqiptar Petro Koleci. I riu nga fshati Kodër, Livadhja i Bashkisë Finiq jetonte prej gati 25 vitesh në shtetin grek, ndërsa banonte në Mandra të Athinës, atje ku ishte edhe kryeqendra e përmbytjeve të mëdha. Mësohet se Koleci punonte si hidraulik në shtetin fqinj. Shqiptari rezultonte i zhdukur prej disa ditësh. Trupi i tij u gjet mes shkafërimeve të përmbytjes, me ndihmën e qenve të reparitit zjarrfikës. Mësohet se 29-vjeçari ishte djali i vetëm i familjes Koleci. Shirat e rrëmbyeshëm sh-




Një nga zonat e përmbytura në Greqi

kaktuan përmbytje të mëdha në Mandra, ku u dëmtuan qindra godina. Ndërkohe shiu ka pushuar, por situata në këtë zonë është kaotike si për vendësit, edhe për familjet shqiptare që jetonin

në atë zonë dhe gjithçka kishin ndërtuar. **PËRMBYTJA NË MANDRA**
Më shumë se 2.000 familje gjenden në kushte të vështira, në qiell të hapur

dhe pothuajse pa asnjë ndihmë nga shteti - ka deklaruar "Top Channel". Tragjedia ka goditur rreth 30 familje emigrantësh shqiptarë, të cilët veçse kanë humbur çdo gjë, tashmë përballen me shumë vështirësi për të mbijetuar. Stefan Bono tregon momentet e tmerrit, kur mëngjesin e së mërkurës ndjeu një tronditje të fortë dhe pa sesi një rrjedhë e furishme uji dhe balte i rrëmbyen makinën dhe përmbytën katin e parë të banesës. "U shqye porta, na mori uji e



Viktima e përmbytjeve në Mandra të Athinës, Petro Koleci

29-VJEÇARI SHQIPTAR

I riu nga fshati Kodër Livadhja i Bashkisë Finiq jetonte prej gati 25 vitesh në shtetin grek, ndërsa banonte në Mandra të Athinës, atje ku ishte edhe kryeqendra e përmbytjeve të mëdha. Mësohet se Koleci punonte si hidraulik në shtetin fqinj.

na përplasi në mur, e më pas te frigoriferi teksa vinim rrotull mes ujit. Për fat të mirë që ishte nusja ime prapa dhe na kapi të dyve, edhe mua, edhe djalin, se do të kishim dalë nga porta për në det. Jam i gjithi i nxirë nga goditjet, vinin tulla e blloqe", rrëfen Stefan Bono. Mes lotëve, Violeta Bono thotë se tashmë humbi çdo gjë kishte, por është e kënaqur që e gjithë familja e saj është shëndoshë e mirë. Ajo thotë se askush nuk iu ka ardhur në ndihmë, madje familja përballen me racizmin e autoriteteve dhe kërkon ndihmën e shtetit amë. "Ndihmë duam nga shteti ynë, sepse këta nuk interesohen fare për neve. Këta janë racistë,

nuk na japin as çizme të veshim. Hyni brenda, por unë nuk kam se me çfarë të ha bukë sot. Askush nuk do t'ia dijë", shprehet Violeta Bono. Përparim Hasaj humbi çdo gjë kishte mundur të krijojë me mund gjatë këtyre viteve në mërgim. Fatmirësisht mundi të shpëtojë fëmijët dhe gruan e tij, falë ndihmës së fqinjit, i cili tërhoqi fëmijët në katin e parë. Edhe Përparimi i bën apel qeverisë shqiptare që t'i ndihmojë, pasi sipas tij, askush nuk do t'i ndihmojë në Greqi. "Vetëm shqiptarët kanë qenë pranë nesh", thotë ai. Por pavarësisht fatqesisë, të bindur se jeta vazhdon, ata thonë se do ta përballojnë edhe këtë vështirësi.

Vijojnë kontrollet, në pranga 5 drejtues mjetesesh

Drejtori i Policisë Rrugore: Rriten masat e sigurisë, 40 viktima më pak se në 2016

TIRANE - Drejtori i Policisë Rrugore, Mitat Tola, në një deklaratë për mediat në kuadër të fillimit të Javës së Sigurisë Rrugore njoftoi shtimin e numrit të kontrolleve në rrugë. Tola tha se synimi i policisë është ulja e aksidenteve rrugore dhe rritja e sigurisë. Ai theksoi se policia tashmë ka rreth 20 radarë të lëvizshëm, të cilët do të mundësojnë kontrolle të vazhdueshme në territore të ndryshme. Sa i takon ndryshimeve në Kodin Rrugor, drejtori i Policisë Rrugore tha se synohet ashpërsim i masave për drejtuesit e mjeteve që përdorin celularin në timon. "Ne kemi menduar sot të fillojmë një javë të intensifikuar kontrollesh për të rritur sensibilizimin, për të pasur sa më pak viktima. Në 2017, kontrollet kanë bërë që të kemi një numër më të ulët të aksidenteve krahasuar me 2016-ën, por edhe 40 viktima më pak se në 2016-ën. Shpresojmë dhe do të punojmë më fort dhe 2017-ta do të mbyllet me rezultate më të mira.



Drejtori i Policisë Rrugore, Mitat Tola

Para kemi festat e fundvitit dhe shumica e emigrantëve kthehen në Shqipëri e trafiku rëndohet, do të ketë kontrolle. Policia rrugore ka një flotë mjetesesh të lëvizshme dhe 20 radarë, që do të zhvendosen në akset me trafik. Masat e policisë kanë qenë 100 mijë më pak", deklaroi ai. Gjithashtu, Policia Rrugore e Tiranës gjatë 24 orëve të fundit ka vijuar kontrollet me drager e radar. Vetëm gjatë mbremjes së të shtunës, 5 drejtues mjetesesh u arrestuan në gjendje të dehur, ku

njëri prej tyre si rezultat i drejtimit të automjetit në gjendje të dehur ka dalë nga rruga, por pa pasoja. Në vijim të kontrolleve rrugore janë pezulluar edhe 28 leje drejtimi. Kontrollet kanë konsistuar në evidentimin dhe ndëshkimin e drejtuesve të mjeteve, të cilët drejtojnë automjetin nën efektin e alkoolit, qarkullojnë me shpejtësi tej normave të lejuara, nuk përdorin rripin e sigurimit, përdorin celularin gjatë drejtimit të automjetit etj. **in.all.**

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW
FALAS



INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK



Rrezikshmëria nga përdorimi i tepërt i antibiotikëve

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA VIROZAT



10 këshilla për parandalimin e gripit te fëmijët

Blerina Dhamo:



◆ Reumatologia:
Cilat janë simptomat e dhimbjeve pa shkak, si mund të trajtohen

Stresi, faktor kryesor në zhvillimin e Fibromialgjisë

"Ende nuk është gjetur një kurë përfundimtare"

• Konsumoni boronica për uljen e rrezikut të sulmeve në zemër

Reumatologia: Cilat janë simptomat e dhimbjeve pa shkak, si mund të trajtohen

Blerina Dhamo:

Stresi, faktor kryesor në zhvillimin e Fibromialgjisë

"Ende nuk është gjetur një kurë përfundimtare"

Voltiza Duro

Shpeshherë, shumë njerëzve i ndodh që të ndiejnë dhimbje të shpërndarë kudo në trup, e cila krijon një ndjesi bezdisëse. Por, këto dhimbje pa shkak mund të jenë sinjalizuese që personi mund të jetë prekur nga Fibromialgjia. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja reumatologe, Blerina Dhamo tregon se deri më tani ende nuk është zbuluar shkaktari kryesor apo kura përfundimtare për këtë sëmundje. Ajo gjithashtu thekson se stresi është një ndër faktorët kryesorë në zhvillimin e sëmundjes, e kështillo një mirëmenaxhim të tij. Mjekja shprehet më tej se kjo sëmundje nuk e rrezikon jetën e pacientit, por ul shumë cilësinë e saj.

Cfarë është Fibromialgjia?

Fibromialgjia është një sëmundje që karakterizohet nga dhimbja e shpërndarë në të gjithë trupin. Vetë fjala Fibromialgji do të thotë dhimbje me origjinë nga fibrat dhe muskujt. Kjo sëmundje ul shumë cilësinë e jetës së pacientit, por nuk e rrezikon atë. Ulja e cilësisë së jetës ndodh pikërisht për shkak të dhimbjes së vazhdueshme, që sjell mungesë efikasiteti në punë dhe në familje. Nuk është zbuluar akoma shkaktari kryesor apo kura përfundimtare e saj. Ngelet një sëmundje kronike, shenjat e së cilës mund të menaxhohen vetëm falë mjekimit të duhur dhe ndryshimeve në stilin e jetesës.

Cilat janë simptomat e kësaj sëmundjeje?


Shenja kryesore është pikërisht dhimbja e shpërn-

darë kudo në trup. Dhimbja zgjat mbi tre muaj dhe ka karakter rëndues dhe bezdisës. Personat me Fibromialgji kanë dhimbje të shtuar në disa pika të trupit. Ato janë të shpërndara në mënyre simetrike në pjesën e qafës, shpatullave, bërrylave, vitheve dhe gjunjëve. Por jo gjithmonë i gjejmë të gjitha këto pika të dhimbshme. Disa herë pacienti ankohet vetëm për dhimbje qafe apo mesi, që mjekohen rëndom si Spondilozet. Në fakt janë dy sëmundje tërësisht të ndryshme. Dhimbja në Fibromialgji shoqërohet shpesh


edhe me ndjesinë e lodhjes. Pacientët ndihen të lodhur, edhe pse mund të kenë fjetur gjatë. Disa herë mund të zgjohen nga gjumi për shkak të dhimbjes ose bllokimit të frymëmarrjes. Pacientët me Fibromialgji mund të kenë dhe probleme të kujtesës, uljes së përqendrimit apo çrregullime të humorit, dhimbje koke, probleme me kyçin e nofullës, madje dhe çrregullime të lëvizshmërisë së zorrës.

Cilat janë kategoritë më të prekura nga Fibromialgjia?

Femrat janë më të predispo-



Mjekja reumatologe, Blerina Dhamo



zuara në krahasim me meshkujt. Gjithashtu, personat me sëmundje reumatizmale si Artriti Reumatoid, Lupusi apo Osteoartriti janë më të rrezikuar për t'u prekur nga Fibromialgji.

Cilat janë faktorët që ndikojnë në shfaqjen e saj?

Shenjat e sëmundjes shpesh mund të shfaqen pas një stresi fizik ose emocional, ndërhyrje kirurgjikale apo infeksioni diku në trup. Pra, mënyra se si ne menaxhojmë stresin është shumë e rëndësishme dhe vendimtare në shfaqjen e sëmundjes. Në disa raste shenjat zhvillohen gradualisht pa ndonjë faktor nxitës. Gjenetika mendohet si faktor ndihmues, pasi është parë një tendencë familjare e sëmundjes. Mendohet se kemi të bëjmë me një mutacion gjenetik në rrugët nervore që përpunojnë sinjalin e dhimbjes. Nga stimulimi i vazhdueshëm nervor, në tru ndodh rritja jo normale e disa substancave kimike përgjegjëse për transmetimin e dhimbjes. Receptorët e dhimbjes në këta pacientë zhvillojnë një formë kujtese të dhimbjes, duke e mbajtur sëmundjen aktive vazhdimisht.

Si bëhet diagnostikimi i kësaj sëmundjeje?

Diagnoza mund të vihet vetëm nga një mjek që e njeh mirë sëmundjen dhe shenjat e saj. Reumatologu dhe neurologu janë mjekët tek të cilët shkojnë më shpesh personat me Fibromialgji. Më parë diagnoza vihet duke u bazuar në ndjeshmërinë e lartë ndaj shtypjes mbi disa

pika të shpërndara simetrikisht në të gjithë trupin. Sot diagnostikimi bëhet edhe nëse nuk janë prezente të gjitha këto pika të dhimbjes. Mjekut i duhen disa analiza laboratorike ose imazherike që të përjashtohen shumë sëmundje të tjera që imitojnë nga Fibromialgjia. E theksoj që nuk ka asnjë analizë specifike për diagnozën. Vetëm mjeku mund ta vendosë diagnozën.

Cilat janë komplikacionet e sëmundjes?

Prania e dhimbjes kronike dhe mungesa e gjumit ndikon negativisht në jetën profesionale dhe atë personale të pacientit. Mosinformimi si duhet për këtë sëmundje shpesh shkakton depresion apo ankth.

Si bëhet trajtimi i Fibromialgjisë?

Që të menaxhohet mirë dhimbja dhe shenjat e tjera të sëmundjes, duhet një bashkëpunim midis pacientit dhe mjekut. Preparatet që përdoren sot në pacientë me Fibromialgji ndihmojnë në lehtësimin e shenjave. Pacientit i këshillohen disa ndryshime në stilin e jetesës, të cilat e ndihmojnë shumë për të bashkëjetuar me Fibromialgjinë. Fillimi i aktivitetit fizik si ushtrimet aerobike, ushtrimet fizike në ujë, ushqyerja e shëndetshme apo vetëmenaxhimi i situatave stresante janë disa nga mënyrat për ta kontrolluar sëmundjen dhe shenjat e saj.

Përdorimi i pakujdesshëm i antibiotikëve dhe lufta kundër antibiotiko-rezistencës është një shqetësim botëror. Kjo sepse rezistenca ndaj antibiotikëve përbën një nga kërcënimet më serioze për shëndetin në nivel global dhe njëherësh një sfidë për sistemin shëndetësor, që mbart me vetvete dhe një kosto financiare të konsiderueshme. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka dhënë alarmin për këtë çështje prej kohësh.

Rreziku

Të dhënat tregojnë se në Europë rreth 25.000 pacientë vdesin çdo vit si pasojë e infeksioneve, të cilët nuk mund të trajtohen me antibiotikë për faktin e rezistencës së krijuar ndaj tyre. Shqipëria ka një konsum të antibiotikëve të përafërt me vendet e rajonit, por edhe me vendet e bashkimit Europian, (22.7 doza për 1 mijë banorë), por të dhënat tregojnë se rezistenca ndaj antibiotikëve po kthehet në kërcënim serioz edhe në vendin tonë. Instituti i Shëndetit Publik bën thirrje që antibiotikët të përdoren vetëm nën rekomandimin e mjekut, pasi marrja e tyre në mënyrë të pakontrolluar mund të sjellë rreziqe për shëndetin.

Efektshmëria

Shumë sëmundje shkaktohen nga bakteret ose viruset. Antibiotikët janë medikamente të rëndësishme, që përdoren për mjekimin e infeksioneve bakterore si në njerëz dhe në kafshë dhe jo në infeksionet virale, por jo gjithmonë ato janë zgjidhje. Antibiotikët po humbasin efektivitetin e tyre, që do të thotë më shumë vdekje dhe më shumë komplikacione për njerëzit, pasi ne nuk po i përdorim ato siç duhet. Nëse bakteret bëhen rezistente ndaj antibiotikëve, shumë mjekime të thjeshta do të bëhen përsëri të rrezikshme për shëndetin tonë. Viruset shkaktojnë sëmundje të zakonshme, të cilat nuk mund të mjekohen me antibiotikë si: gjendje gripale, kollë, rrjedhje hundësh, dhimbje fyti, bronkiet dhe disa infeksione të sinuseve apo të veshit. Marrja e antibiotikëve sjell rreziqe të mundshme për shëndetin. Antibiotikët duhet të përdoren vetëm kur mjeku i rekomandon ato si të nevojshme për sëmundjen.

Përdorimi i antibiotikëve mund:

-Të vrasë bakteret e mira që ndodhen në trupin e njeriut, gjë që mund të çojë në komplikacione të tilla si diarje.

-Të shkaktojë reaksione alergjike serioze, të cilat mund të kërkojnë shtrim në spital.

-Të rezultojë në zhvillimin e infeksioneve rezistente ndaj antibiotikut. Bakteret rezistente janë të vështira për t'u eliminuar. Ato mund të qëndrojnë në trupin e njeriut dhe mund të shkaktojnë sëmundje të rënda. Mjekimi për një infeksion rezistent mund të kërkojë një trajtim me antibiotikë më të fuqishëm



Instituti i Shëndetit Publik: Të merren vetëm nën rekomandimin e mjekut

Rrezikshmëria nga përdorimi i tepërt i antibiotikëve

OBSH jep alarmin edhe për Shqipërinë



(antibiotikë të gjeneratës së 2-të ose 3-të), ndoshta edhe shtrim në spital.

Përdorimi i antibiotikëve

Antibiotikët janë medikamente, të cilat shpëtojnë jetë. Përdorimi i antibiotikëve në mënyrën e duhur

është mënyra më e mirë për të ruajtur efektivitetin e tyre për sëmundjet bakterore. Antibiotikët trajtojnë vetëm infeksionet bakterore. Nëse keni një infeksion viral si një të ftohur, ju duhet të bisedoni me mjekun për mënyrën sesi të lehtësoni sim-

ptomat e sëmundjes. Këshillat mund të përfshijnë lëngje të ngrohta, pushim. Disa infeksione të veshit nuk kërkojnë përdorimin e antibiotikëve. Mjeku do të përcaktojë llojin e infeksionit të veshit që keni dhe nëse është i nevojshëm përdorimi i antibiotikëve. Mjeku mund të presë disa ditë përpara se të japë antibiotikun, pasi ju mund të ndiheni apo bëheni më mirë edhe pa filluar antibiotikun. Pjesa më e madhe e rasteve me dhimbje fyti nuk kërkojnë trajtim me antibiotikë. Vetëm 1 në 5 fëmijë të cilët janë vizituar nga mjeku për dhimbje fyti kanë infeksion të fytit të shkakuar nga streptokoku, i cili duhet trajtuar me antibiotikë. Mjeku mund ta konfirmojë këtë infeksion vetëm me kryerjen e testit me material nga fyti.

Mukusi me ngjyrë jeshile nuk është shenjë që duhet të fillojmë një antibiotik. Meqenëse sistemi imunitar i trupit lufton infekcion,

mukusi mund të ndryshojë ngjyrë. Kjo është një dukuri normale dhe ju nuk keni nevojë të merrni antibiotikë. Përdorimi i antibiotikëve mund të shkaktojë komplikacione, duke filluar nga një irrimim i stomakut deri në reaksione alergjike serioze. Mjeku juaj duhet të vlerësojë përfitimet dhe rreziqet përpara se të përkrahë një antibiotik. E rëndësishme është që antibiotikët të përdoren në mënyrën, llojin dhe dozën e duhur, si dhe në kohën dhe për periudhën e duhur.

Ja disa veprime të thjeshta:

Mos kërkonte antibiotikë, por trajtoni simptomat e gjendjes gripale dhe të kollës sipas këshillave të mjekut. Merrni antibiotikët siç përshkruhen nga mjeku. Mos i ruani antibiotikët për t'i përdorur në të ardhmen. Mos i ndani antibiotikët me të tjerët.

MARRJA E ANTIBIOTIKEVE NË RASTIN E SËMUNDJEVE VIRALE:

- Nuk do t'iu shërojë nga sëmundja që keni.
- Nuk do t'iu ndihmojë që të ndiheni më mirë.
- Nuk do t'i mbrojë të tjerët nga sëmundja juaj.

10 këshilla për parandalimin e gripit te fëmijët

Në këtë periudhë të vitit, klima e ftohtë sjell edhe virusat stinore si gripin, dhimbjet e fytit, ftohjen e pneumoninë, e një ndër kategoritë më të prekura janë fëmijët. Kështu që, prindërit duhet të tregohen shumë të kujdesshëm e të marrin masa parandaluese për t'i mbrojtur vogëlushët nga këto sëmundje. Më poshtë po japim 10 këshilla të vlefshme për të mbrojtur fëmijët tuaj nga virusat e ndryshme stinore.

1. Sigurohuni që fëmija juaj të bëjë vaksinën e gripit këtë sezon

Edhe pse vakcina nuk mund të parandalojë plotësisht marrjen e gripit nga vogëlushët, pasi është deri në 62% efektive, mund të ndihmojë që edhe në rastet e prekura, sëmundja të kalojë më shpejt.

2. Kujdes kur kolliteni apo teshtini

Infeksionet e gripit mund të përhapen shumë shpejt përmes kollës dhe teshtitjes, kështu që mësoni fëmijët të mbulojnë gojën dhe hundën me një shami dhe sigurohuni që të pastrojnë duart vazhdimisht.



3. Mbani fëmijët tuaj në shtëpi

Nëse vogëlushët janë të sëmurë duhet t'i mbani në shtëpi e kërkojuni mësuesve që të mbajnë tavolina në klasë të ndara dhe jo t'i shtojnë së bashku për të formuar tavolina më të mëdha. Gjithashtu, fëmijët e prekur nga gripin duhet t'i mbani në dhomën e tyre si dhe merrni

parasysh shmangien e turmave të mëdha.

4. Mbani duart dhe sondet/sipërfaqet e përbashkëta të pastra

Kjo është koha më e rëndësishme e vitit për larjen e duarve. Mësoni fëmijët që të lajnë duart për të paktën 20 sekonda. Virus i gripit

mund të jetojë deri në 8 orë në sipërfaqe, kështu që përpuni të hiqni mikrobet nga lodrat, tavolinat, telefonat, duke përdorur ujë të nxehtë me sapun ose një produkt pastrimi të posaçëm dezinfektues.

5. Diell e ekullibruar

Ofrojini fëmijës tuaj një dietë të ekuilibruar, duke përfshirë fruta, perime, qumësht dhe ujë. Sigurohuni që fëmija të ketë bërë mjaftueshëm gjumë (të paktën 10 orë për fëmijët e moshës shkollore dhe 12 orë për të vegjël). Inkurajoni të paktën një orë aktivitet fizik në shumicën e ditëve të javës.

6. Mos lu afrooni personave të sëmurë

Paralajmërojeni fëmijën tuaj të qëndrojë larg nxënësve të sëmurë në klasë. Kërkoni edhe vitaminat A, C, E dhe ato të cilat përmbajnë selenium dhe zink për t'u mbrojtur nga sëmundjet.

7. Konsumoni lëngje

Ruani në shtëpi supë dhe ushqime të nxehta, të cilat do t'ju ngrohin gjatë stinës së dimrit. Konsumoni vazhdimisht pije të nxehta si çaji, kafeja apo të tjera. Çaji është shumë i mirë për dhimbjen e fytit. Çaji i gjel-

Nëse vogëlushët janë të sëmurë duhet t'i mbani në shtëpi e kërkojuni mësuesve që të mbajnë tavolina në klasë të ndara dhe jo t'i shtojnë së bashku për të formuar tavolina më të mëdha. Gjithashtu, fëmijët e prekur nga gripin duhet t'i mbani në dhomën e tyre si dhe merrni parasysh shmangien e turmave të mëdha.

bër dhe çaji me limon dhe mjaltë janë pijet më popullore të konsumuara në ditë e ftohta.

8. Merrni vitamina

Sigurohuni që pjesëtarët e familjes tuaj së marrin vitamina të bollshme çdo ditë. Kur nuk gjeni fruta apo perime të cilat janë të pasura me vitamina, mund të përdorni tabletat e vitaminave në mëngjes ose në darkë. Mbani në çantë tableta vitaminë C edhe për dhimbjet e fytit. Nëse ndjeni shenjat e ftohjes apo gripit, merrni menjëherë një nga këta tableta.

9. Veshje të ngrohta për vogëlushët

Përpuni të qëndroni në shtëpi së bashku me fëmijët kur është shumë ftohtë apo kur bie shi. Mos e nxirni fëmijën jashtë me flokë të lagur. Mbajini në vend të thatë dorezat, kapuçin dhe këpucët që përdor kur luan jashtë.

10. Medikamentet që ju duhen

Para se të vijë dimri gjeni dhe mbani në shtëpi qetësues dhimbës, zhblokues hundësh dhe ilaçe kundër alergjisë. Kontrolloni dhe termometrin nëse punon.



Këshilla

Konsumoni boronica për uljen e rrezikut të sulmeve në zemër

Fruti i ëmbël dhe ushqyes i boronicës jep përfitime shëndetësore afatgjata për të gjithë ata që e konsumojnë. Ato janë të pasura me antioksidantë, çka ndikon pozitivisht në luftimin e kancerit, plakjes e humbjen e peshës. Pa yndyrna dhe me vetëm 84 kalori për një kupë, boronicat janë të pasura me fibra që të mbajnë të ngopur për një kohë të gjatë. Gjithashtu, fruti i vogël i purpur është i pasur me vitaminë C, vitaminë K, mangan dhe antioksidantë të tjerë, që ndikojnë në parandalimin e shumë sëmundjeve. Rezultati ORAC i boronicave është i pabesueshëm, pra 9.621, gjë që e bën atë një nga bimët me vlera të larta antioksiduese në botë. Antioksidantët ndihmojnë trupin tuaj të mbrojë veten kundër patogjenëve të rrezikshëm. Ndërkaq, boronicat njihen si "agjentë neuro-mbrojtës". Sipas studuesve të kryera në Iran, kjo do të thotë se ato mund të mbrojnë trurin tonë nga degjenerimi, neurotoksiteti dhe stresi oksidativ. Një tjetër studim zbuloi se konsumimi i më shumë boronicave ndikon në përmirësimin e memories. Më tej është zbuluar se fruti i boronicës mund të vrasë kancerin pa dëmtuar qelizat



e shëndetshme. Ndërkaq, duke qenë një burim natyror i fibrave të tretshme dhe të pazgjidhshme, boronicat mund të ndihmojnë rregullimin e sistemit të tretjes, vetëm me konsumimin e disa grushteve në ditë. Madje, nëse boronica kombinohet me luleshydhe, ul rrezikun e sulmit në zemër deri në 33 për qind.

Përfitimet shëndetësore të boronicave janë treguar gjithashtu në uljen e kolesterolit dhe tensionit të gjakut. Por fruti i ëmbël shërben edhe si një ilaç i shkëlqyer për aknet e për një lëkurë sa më të shëndetshme, edhe nëse përdoret në kushte shtëpia. Duke qenë se sasia e kalorive është e ulët te boronicat, këshillohet të konsumohet nga ata persona që duan të bien në peshë pasi mund të ndihmojnë në kontrollin e oreksit.



Rigoni, luftues i infeksioneve dhe inflamacionit

Bima e rigonit, pjesë e familjes botanike *Oreganum vulgare* është mjaft e njohur në mjekësinë popullore, por edhe më gjerë për efektet e tij çudibërëse në organizmin e njeriut. Gjethet e kësaj bime mund të përdoren të thata apo të njoma, por mund edhe të grihen e të përdoren në çaj. Përveç aromës së tyre të fortë, gjethet e rigonit përbajnë 40 përbërës aktivë mjekësorë. Këto gjethe janë një kurë tradicionale në mjekësinë popullore, ndërkohë që shumë studime klinike kanë vërtetuar dobinë e madhe dhe rëndësinë shëndetësore të çajit të rigonit. Studiuesit kanë zbuluar se shumë prej përbërësve aktivë të rigonit i përkasin kategorisë së polifenolëve, flavonoidëve dhe anthocianinës, që njihen për aftësitë e tyre antioksiduese. Antioksidantët mbrojnë qelizat nga radikalet e lira, të cilat janë kimikate të paqëndrueshme, që formohen nga tretja problematike, gjenden në lëkurë kur jeni të ekspozuar në rrezet e diellit, apo tek organet kur ekspozoheni ndaj toksinave mjedisore siç është tymi i duhanit. Gjithashtu, rigoni lufton virusat dhe shkurton kohëzgjatjen e gripit, që ka simptoma si: temperaturë e lartë, kollë, dhimbje koke, të vjella, mungesë oreksi, dhimbje trupi etj. Kjo bimë aromatike është një burim i kaliumit dhe mban nën kontroll ritmin e zemrës dhe tensionin e gjakut kur organizmi përballet me sasi të larta të sodiumit. Antioksidantët që gjenden tek rigoni ndihmojnë në parandalimin dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara nga stresi oksidues dhe sëmundjet e zemrës. Për më tepër, rigoni është një burim natyral i acideve yndyrore të Omega-3, të cilat ndihmojnë në uljen e inflamacionit dhe rrezikun e sëmundjeve të zemrës. Çaji i rigonit ndihmon në parandalimin dhe ngadalësimin e rritjes së mikroorganizmave të dëmshëm. Një studim zbuloi se përbërësit e gjetheve të rigonit kishin vlera të rëndësishme dhe luftonin ashpër rritjen e infeksioneve dhe përhapjen e inflamacionit. Rigoni njihet edhe për aftësinë e çlirimit nga dhimbjet dhe spazmave muskulore. Nëse vuani nga probleme të tilla, pini çaj rigoni dhe dhimbja do të pushojë në një kohë shumë të shkurtër.



INTERVISTA

Një rrëfim për fëmijërinë e tmerrshme, varfërinë e tejskajshme, censurën dhe jetën nën diktaturë, miqësinë me Petro Markon, çantën prej lecke dhe margarinën që sillte UNRRA. Shkrimtari që gëzon fëmijët prej 40 vitesh pret nga 2009 pensionin special...

Gaqo Bushaka

Fëmija i trishtuar me këpucë prej lecke, që u bë shkrimtar

Fatmira Nikolli

Babai' i Çufos, ishte biri i dy prindërve që nuk dinin as të hidhnin firmën. Qe veçse dy vjeç kur nga Gjirokastri, e sollën në Tiranë. Jetonte në një dhomë të vogël, të lagësht, të ngushtë. Qenë kaq të varfër. Në shkollë shkonte me këpucë të grisura. Librat e fletoret i mbante në një çantë prej lecke, vishej keq, dukej keq, ndihej keq. Ishte i shkurtër aq sa humbte në bankë. Mezi priste pushimin e gjatë në shkollë që të pinte pak qumësht pluhur, të merrte margarinë dhe galeta. Ishin ndihmat e UNRRA-s për vendet fitimtare të luftës. "Kam pasur një fëmijëri të tmerrshme", - thotë Gaqo Bushaka kur e pyes nëse fëmijëria ka ndikuar në qasjen e tij të parë ndaj letërsisë për fëmijë.

Nuk e pranon hapur që ka një lidhje mes fëmijës së palumtur që u rrit për të shkruar që të gëzonte fëmijët e një Shqipërie nën diktaturë. "Ata vuanin shumë".

Megjithatë, shton se të paktën atëherë ishin të gjithë njësoj, ndaj shokët nuk të shanin. Të gjithë kishin kukualla prej lecke, çantë prej lecke, topa prej lecke dhe një jetë, kishin të tërë një jetë prej lecke!

Familjet e rrugës së tij, Karapicët e famshëm, e mbanin afër: "Jam rritur duke lypur". Por ai nuk ka lypur në rrugë, as bukë. Ka lypur libra, nga kushdo, kurdo, duke krijuar një botë të re, brenda dhomës ku ngryesj e gdhijehj. Merrte jetë borxh nga ilustrimet e librave.

74-vjeçari që kam përballë është ende një fëmijë në trupin e një burri. Një fëmijë i vuajtur që është bërë i fortë me zor, që burgos brenda atij trupi dhimbjen që e ka shtypur.

74-vjeçari që kam përballë është një mjeshtër që ende nuk i kanë dhënë pensionin special, ata që janë rritur me përrallat e tij.

74-vjeçari që kam përballë, është megjithëkëtë një burrë krenar, si Petro Marko, si letërsia e tij. Ai ka vendosur që nëse mbetet, është për meritë të tij.

74-vjeçari që kam përballë nuk lyp asgjë, nuk kërkon lëmoshë, por në zërin e tij ndje zhgënjim për fëmijët që dikur bëri të lumtur e që sot janë rritur për të qenë bur-

"Shkruaj se dua të bëj të lumtur fëmijët, pse ma dha 'Çmimin e Republikës' Mehmet Shehu"

"Babai" i Çufos, në një rrëfim për letërsinë: Isha i varfër, merrja borxhe

Unë kam pasur një fëmijëri shumë të hidhur. Kam qenë shumë keq ekonomikisht. Babai dhe nëna ime nuk dinin as të hidhnin firmën. Kisha shumë privacione ekonomike. Madje, deri edhe librat për të lexuar i merrja borxh.



Gaqo Bushaka



nxjerrë një libër të ri të shtëpia botuese "Toena" për gjakmarrjen.

- Pse për gjakmarrjen?

E kisha peng këtë, sepse kisha parë e kam takuar njerëz të tillë që e kishin këtë plagë. Më vriste fakti që shihja fëmijë 10-12 vjeçarë që ngujoheshin. I shkatërrohet fëmijëria tërësisht. Ndahet nga shokët, nga shkolla, nga librat dhe do rrijë gjithë jetën të shohë tavanin. Do jetojë me helm. Ai do presë që dikush t'i bjerë derës e t'i çojë çorbë, supë a bukë. As "Kanuni" nuk respektohet se po vrasin edhe vajza. Është një tragjedi që më ka mbetur në mendje. Punova me këtë roman tre vjet.

- Çfarë ju frymëzonte për Çufon?

Edhe në kohën e Enver Hoxhës, unë shihja se fëmijët vuanin, kishin probleme, do shkonin të mbanin radhë për të marrë qumësht. Do shkonin në shkollë me këpucë të grisura, siç ndonjëherë shkoja edhe unë, edhe me çantë lecke. Fillimisht edhe buka ishte me triska dhe po të të humbte triska, të humbte emri. Megjithatë, ishte një sistem që pak a shumë ishim aty të tërë dhe nuk e tallnin njëri-tjetrin.

Tani shoqëria është në shkallë të ndryshme dhe ai që është me mua sot, nesër bëhet ministër dhe pasnesër është dikur tjetër. Si u vunë lekët është punë tjetër, secili jep llogari për punët e veta, unë jap për punët time. Kam arritur në përfundimin se nëse unë mbetem shkrimtar për fëmijë, është merita ime, nëse nuk mbetem, është faj i im.

- Pse e shkruat Çufon?

Doja që të bëja një libër që fëmijët të qeshnin, të gëzoheshin, të ishin lumtur. Ky ishte qëllimi im dhe e arrita.

- Si u profilizove te letërsia për fëmijë?

Janë disa gjërat që t'i jep Zoti thotë populli. Një herë Limoz Dizdari më kërkoi një tekst kënge për të rritur. E bëra tekstin e këngës, por kishte dalë prapë për fëmijë. →



Librat e Gaqo Bushakës

← - A ka lidhje pasioni juaj për letërsinë për fëmijë edhe me fëmijërinë tuaj?

Unë kam pasur një fëmijëri shumë të hidhur. Kam qenë shumë keq ekonomikisht. Babai dhe nëna ime nuk dinin as të hidhnin firmën. Kisha shumë privacione ekonomike. Madje, deri edhe librat për të lexuar i merrja borxh. Lexoja më shumë se të tjerët dhe kur e panë më pas shumë njerëz që vërtetë lexoja shumë dhe filluan të më thërrisnin vetë, më jepnin shumë libra. Pra me të lypur. Shumë keq.

- Mbase pikërisht për këtë, nuk keni dashur që fëmijët e tjerë të ishin si ju?

Jo, doja që ata të gëzoheshin. Ndaj e bëra këtë libër. Kur fillova të shkruaj në Bibliotekën Kombëtare, ata thoshin ka ardhur një i qmendur këtu, sepse unë e shoh të gjallë skenën që bëj dhe ose mërzitem, ose qesh. Pastaj u mësuan dhe më deshën shumë, më ruanin vendin.

- Ju keni jetuar në Gjirokastrë?

Jo, kam ardhur në Tiranë 2 vjeç.



Petro Marko ishte një njeri i shkëlqyer. Pati një jetë shumë të vështirë, por një njeri shumë i mirë, asnjëherë nuk u dha asnjëherë nuk arriti t'i puthi këmbët njeriu, ishte shumë krenar. Burrë fisnik. E kisha afër shtëpisë dhe shkoja e rrija ndonjëherë me të.

Ndoshta ky është shkak që më kanë bërë "Qytetar Nderi" të Tiranës dhe jo të Gjirokastrës. Vërtetë i kam borxh popullit të Tiranës. Më kanë dashur, më kanë respektuar, më kanë ushqyer ndonjëherë. Mbarova shkollën, më pas dy universitetet, Gjuhë-Letërsi dhe Gazetari. Tiranasi ishin njerëz vërtetë të mirë e të dashur, e pa hile. Mba j mend njëherë, ishte një Sefë Karapici i thoshin, i thërret nënës sime, që quhej Amalie, "o Amali, kur të vijë Dylberi, i thuaj që ia kam lënë çelësin të hatlla". "O xha Sefë", i thashë, "e morën vesh gjithë lagjia ku e ke çelësin". "Hë mor çun se s'gjen gjo", tha xha Sefa.

- Ku banonit atëherë?

Pas Muzeut Kombëtar. Ishin njerëz shumë të mirë. Ishin Pash-

kë, çoheshin vezë të kuqe, ishte Bajram vinin petulla, byrekë me qumësht.

- Letërsia për fëmijë ka pasur probleme me censurën?

Çdo gjë ka pasur probleme me censurën. Asgjë e shkruar nuk ishte pa censurë. Jo të gjithë shkonin në burg, por ishte vetëm një shtëpi botuese dhe aty kontrolloheshin.

- Ju kishit probleme?

Vetëm njëherë. Botova tri romane historike rresht. "Djaloshi nga Dyrrahu", "Guna e zezë" dhe "Kalorësi i Skënderbeut". U kritikova që nuk shkruaja për realitetin, por shkruaja romane historike. Pas kësaj, nga frika bëra novela, por besoj se janë gjërat më të dobta që kam bërë. Por, njeriu ka mend në kokë, ndonjëherë e mbron veten. Në burg hyje për politikë. Ç'ti bësh, që ndonjëherë hyn si hajdut e del si politikant, se edhe kështu ka pasur.

- Me Çufon janë rritur edhe familja e diktatorit, por edhe fëmijët e familjeve të ish-Blokut. A kishit ju frikë nga kjo, se mund ta lexonin e mund të mos u pëlqente? Kanë folur me ju ata?

Unë pata një fat. Librin tim të parë e kishte lexuar Mehmet Shehu. Kur shkonin propozimet për të caktuar çmimet e Republikës, ia tregonin edhe atij emrat. Ai kishte parë emrat dhe u kishte thënë se në listë nuk e sheh emrin e Gaqo Bushakës. U kishte thënë që i biri, Bashkimi (Shehu), kishte sjellë një libër në shtëpi. "E dini ju që e lexova, qesha edhe unë. Qeshi Mehmet Shehu". Nuk e zgjatën dhe më dhanë edhe mua çmimin e Republikës për Çufon. Ky ka qenë sebepi. Libri në fakt u pëlqye shumë.

- Po Nexhmije Hoxha?

Nuk di që ka folur keq kurrë. Shkova dy vjet në Berat e Skrapar, gjoja për të njohur jetën, por edhe të tjerë kanë shkruar, nuk është ndonjë problem ky.

- Ka mungesë vëmendjeje për letërsinë për fëmijë sot?

Nuk e përcaktoj dot. Nuk ka vëmendje fare ndaj letërsisë, jo vetëm për atë për fëmijë. Mbase

mjetet elektronike kanë ndikuar. Them se Ministria e Arsimit me atë të Kulturës duhet të sponsorizojë që fëmijët të mos heqin dorë nga libri. Pavarësisht mjeteve elektronike, libri është tjetër - e merr, e prek, e shikon, e lexon kur të duash, sheh ilustrimet, i merr i nënvizon. Diçka duhet bërë se sot nuk po shoh asnjë shkrimtar tjetër që të shkëlqejë siç pati në kohën tonë.

Edhe me ministren në takimin e hapjes së panairit, i diskutuam problematikën si 15% i taksës. Aka ma ka TVSH libri. Se mos mendojnë këta politikanët që kanë bërë libra dhe bënë namin. Librat e tyre shiten prej pozitës që kanë. Çufo ka 40 vjet që botohet e akoma e kërkojnë atje, ndërsa këta 40 ditë kanë dhe harrohet libri i tyre.

- A është pak e paragjykar letërsia për fëmijë? A duket sikur shkrimtar i madh është ai që shkruan për të mëdhenjtë, jo për të vegjlit?

I paragjykar shumë. Kam 8-9 vjet që më është aprovuar nga ish-ministri i Kulturës, Ardian Turku, një pension special. Aka ma sot nuk ma kanë dhënë. Ndoshta presin që të vdes e të ma japin pas vdekjes. Për mua është një lloj turpi. Atë le ta shohin e qoftë edhe për respekt, le të më thonë mua, që ta kanë aprovuar, por ne nuk e quajmë të drejtë që ti ta marrësh këtë pension. Dhe njeriu mbleh mendjen. Unë nuk do isha ankuar kurrë po të më thoshin kështu. Por të mos japësh një lajm të vetëm për 5-6 vjet e të mos geshh dy minuta t'i thuash Gaqo Bushakës: 'Ore nuk të takon kjo, por rri rehat'. Por as këtë nuk e bëjnë.

- Librat tuaj kanë pasur e kanë shumë të bukura edhe ilustrimet. Me kë bashkëpunonit dhe a i diskutonit bashkë apo i zgjidhte piktorit sipas historive?

Kam bashkëpunuar me Safo Markon. Ishte një piktoresh e mrekullueshme. Një libër me përballa, "Përrallat e shiut", që i ka botuar "Çabej" i bëri në mënyrë të shkëlqyer Zamir Mati. Kurse një libër tjetër, e ka ilustruar Bujar Kapexhiu. Atij i pëlqyen përrallat dhe i bëri vetë.

Me Safon bashkëpunova se ishim atje te Naim Frashëri. Unë kisha mik Petron dhe e doja shumë.

- Si ishte Petro Marko si mik?

Ishte një njeri i shkëlqyer. Pati një jetë shumë të vështirë, por një njeri shumë i mirë, asnjëherë nuk u dha asnjëherë nuk arriti t'i puthi këmbët njeriu, ishte shumë krenar. Burrë fisnik. E kisha afër shtëpisë dhe shkoja e rrija ndonjëherë me të. E gjeja vazhdimisht me cigare në gojë, me makinën e shkrimit. Edhe Safo ka punuar shumë pime, ishte piktoresh e mire dhe ishte një njeri që e njihite letërsinë për fëmijë.

- E ka njeri pasionin tuaj? A shihni pasardhës?

Nuk di ç'ti them. Është dhunti. Kujt mund t'i shkonte mendja që një djalë i varfër si unë, me ato këpucët prej lecke, me një çantë lecke, i veshur keq, shumë i shkurtër sa humbisja në bankë, vetëm gishtit më shihej. Qejfi ynë më i madh ishte, kur pas pushimit të madh ne na jepnin qumësht në shkollë. Nuk kishte, ishte shumë vështirë. Shqipëria u radhit në vend fitimtarë të luftës. Dhe UNRRA kishte prurë qumësht pluhur, margarinë, ishin edhe ca si tip

SHUHET PAPRITUR NË MOSHËN 68-VJEÇARE KOMPOZITORI ALEKSANDËR LALO



Mbrëmjen e së dielës është ndarë nga jeta papritur kompozitori i njohur shqiptar, Aleksander Lalo. Kompozitori u shua në moshën 68-vjeçare si pasojë e një ataku kardiak. Njostimin e dha së pari miku i tij, Petrit Ruka. "Miq po ju njoftoj nga spitali se sapo ndërroi jete miku im më i afërt, kompozitori Aleksander Lalo... Dhembe pa fund...", shkroi ai, ndërsa Lalo shfaqej në një spektakël të regjistruar ditë më parë. Aleksander Lalo është një nga kompozitorët më të njohur shqiptarë me një punë voluminoze nga krijimi i kolonave zanore më të spikatura të kinematografisë shqiptare deri te kompozimet e këngëve për festivale dhe vepra simfonike. Kineasti Mevlan Shanaj shkroi mbrëmë vonë se, "Qe therëse kjo mbrëmje. Paska ikur Lalo, mik, artist, bashkudhëtar, bashkëpunëtor. Talent që nuk harrohet. Humbje që të artin shqiptar. Dhimbje që të shtërngon dhe nuk ke fjalë. Lamtumirë Aleksander Lalo!".

"KLAN" NDËRPRET TRANSMETIMIN

Maestro Lalo së fundmi ishte pjesë e produksionit më të ri të Televizionit "Klan", "C'est la vie". "Teleshikues të televizionit 'Klan', po ndërpresim rrjedhën normale të programacionit, të spektaklit të cilin po e ndiqni, pas ndarjes në mënyrë të papritur pak minuta më parë nga jeta të kompozitorit të njohur, Aleksander Lalo. Në shenjë respekti, TV 'Klan' nuk do të vazhdojë mbrëmjen e sotme transmetimin e spektaklit, pjesë e të cilit ishte edhe Aleksander Lalo nga java e parë", tha Reis Çiço.

biskotash të mëdha, quheshin gale-ta. Kur mbaronte ora e dytë dilnim në pushim dhe aty e kishim mendjen, të hanim nga këto. Megjithatë na bënë mirë, se në shtëpi ato kishim të gjithë.

- Si i gjenit libra?

Indërronim me njëri-tjetrin. Në fillim ishte vështirë, pastaj i botuan disa. Propagandës atë kohë ju dha shumë rëndësi, sepse lekët i kishte shteti. Leximet jashtë klase botoheshin deri në 50 mijë kopje.

- Lexonit letërsi të huaj?

Përkthime si "Aventurat e Hakëlberit Finit", "Aventurat e Tom Sojerit", "Pinoku", "Përrallat e 1001 netëve". I kam parë në fillim te "Albania" e Konicës.



Gaqo Bushaka me librin e tij të fundit

Opinion *i* Ditës

Nga Gjovalin Shkurta

(Vijon nga faja e parë)

... u bë një veprimtari e bukur shkencore e kulturore artistike, e cila kishte si temë bosht 100-vjetorin e botimit të vëllimit poetik "Juvenilia". Në vitin 1917, në Vjenë të Austrisë, poeti botoi librin e tij të parë dhe të fundit të jetës, të quajtur me një titull latin, vezullues dhe të përjetshëm "Juvenilia". Ky libër është padyshim një nga librat më të rëndësishëm të poezisë shqipe në 5 shekuj të ekzistencës së saj të shkruar, që nga Gjon Buzuku e deri më sot. Kjo ditë, e cila ka hyrë tashmë në listën e veprimtarive të përvitshme, që bëhen në atë mjedis, sivjet përkonte edhe me ditëlindjen e poetit tonë kombëtar Dom Ndre Mjeda (20 nëntori 1866), prandaj drejtuesi i qendrës, dr. Dom Nikë Ukgjini, në bashkëpunim e me mbështetjen e ministres së Kulturës Mirela Kumbaro, bëri edhe përrurimin e ribotimit të veprës "Juvenilia", botim anastatik nga Botime "Gj. Fishta", Lezhë. Ishte një veprimtari e bukur, sa e thjeshtë, aq edhe me përmblajtje e vlera të shënueshme shkencore, kulturore dhe artistike, me pjesëmarrje të një numri të mirë personalitetesh zyrtare e studiuesish të njohur, midis të cilëve edhe zëvendëskryeministria, Senida Mesi, ministria e Kulturës, prof. Mirela Kumbaro, konsulli nderit të Austrisë Gjergj Leqejza, akademikë nga Tirana dhe profesorë e studieve nga Universiteti i Shkodrës "L. Gurakuqi", si dhe dashamirë të Dom Ndreut. Ndër ta, edhe skulptori i njohur, prof. Sadik Spahiu, realizues i shtatoreve madhështore të Dom Ndre Mjedës, që është vendosur në oborrin e Qendrës Muzeore kushtuar poetit të shquar kombëtar, priftit dhe veprimtarit shoqëror e atdhetarit të flaktë Dom Ndre Mjedës. Veprimtaria ishte njëjtuar si një "meshë" artistike dhe kulturore shkencore, një gjë sa e re, aq edhe origjinale, përdërisa salla ku u organizua, ka qenë kisha e famullitare e Kuklit, ku Mjeda jetoi e meshoi për shumë vjet.

Na uroi mirëseardhjen drejtori i qendrës muzeore Dom Nikë Ukgjini, pastaj, në shoqërimin e këndshëm të një tresheje orkestrale dhe interpretime të poezive të Mjedës nga një grup nxënësesh të gjimnazit "Jordan Misja" të veshura me kostumim tradicional të Zadrimës. E merrnin fjalën të ftuarit, duke sjellë secili mesazhe të formulaara shkurt që synonin vlerësimin e jetësimit e asaj pune madhështore, që është bërë në atë fshat të vogël për Mjedën e Madh. Përpos pohimeve me karakter zyrtar e sidokudo edhe solemn, nga përfaqësuesit e shtetit e Bashkisë të Vaut të Dejës, u mbajtën edhe kumtesa shkencore rreth veprës "Juvenilia" dhe kreu shkriarisë e veprimtarisë së Ndre Mjedës, nga studiues, shkriarimë, poetë dhe arsimtarë të pranishëm. Përmendim referimet e prof. dr. Tomor Osmani "Mjeshtri i Madh", i cili vlerësoi ndihmesat e Mjedës si anëtar i Komissës Letrare të Shkodrës dhe si gjuhëtar i dalluar;

"Shqyptarija", liria e shqipja në jetën e Dom Ndre Mjedës



prof. dr. Alfred Çapaliku, i cili u ndal në vlerat artistike të poezive të Mjedës në përgjithësi e të "Juvenilias" në mënyrë të veçantë. Kumtuan edhe studiues nga Kosova, Zija Vukaj dhe prof. dr. Agim Vinca, kumtesën e të cilit kushtuar artit të Mjedës si poet i veçantë e lexoi Erlinda Ramadani.

Me këtë rast, në vargun e kumtesave, unë lexova një pjesë të kumtesës sime me titullin "Shqyptarija" dhe përbashkësia e gjuhës si dëshmi e njësisë së kombit shqiptar në veprat e Ndre Mjedës. Rasti e donte që, të ritheskoja disa vlerësime, që i kam shprehur edhe më parë në disa shkrime për Mjedën, duke përfunduar mendimin se Ndre Mjeda, goftë në vjersha e poema, goftë edhe në kreu veprimtarinë e tij shkencore, atdhetare, politike, arsimore etj. mbetet një nga prijësit dhe luftëtarët më të zjarrtë që përbashkësia e gjuhës të ishte mjeti kryesor i njësim-it e përparimit të kombit shqiptar. Tëhun e asaj që mund të themi e kemi njëjtuar në këto tri fjalë celës: Shqyptarija, liria dhe gjuha shqipe. Ato ishin, janë dhe mbeten leksemat jo vetëm më të shpeshta, por edhe më të dashurat, më atdhetaripohueset në veprimtarinë e shkriarinë e Ndre Mjedës. Vjershëria e Ndre Mjedës ka "vulltë" të dukshme e të theksuar atdhetare, duke dalë, ashtu si bashkëkohësi e bashkëvendësi tjetër zadrimor, Atë Fishta, ideator dhe mëtuës i pamposhtur i pohimit:

Kjoftë mallkue, kush qet ngatrimë, Nder kta vllazën shoq me shoq/kush e dan me fjalë e shkrimë, / Ça natyra vetë përpoq!" "Shqyptarija", të cilën Mjeda e

shkruan gjithmonë me shkronjën të madhe, të Mjeda, kjo fjalë është zgjedhur si figurë e gjallë, e shenjtëruar, e shpirtëzuar, sikundër shihet, mbi të gjitha, te soneti "Andërr", personifikimi me vlerë madhore dhe absolute kombëtare, simbol i devotshmërisë, i përkushtimit dhe virtyeteve që përbëjnë identitetin shpirtëror të njeriut, të atij që i thotë vetes shqiptar: "Shqyptarija" ka qenë të Mjeda motëzimi i vetë qenies së tij, prandaj, edhe kur botoi "Andërr", sikundër e ka përmendur edhe studiuesi Sabri Hamiti, ai nënshkroi me pseudonimin "Shqyptari". Vetë lokja, nëna a tija, e kishte ushqyer që në moshë të njomë duke i thënë: "Nji nanë tjetër, thoshte ke./ Bir, n'ket dhe./ Nana jote asht Shqyptarija". Vjershat dhe poemat e Ndre Mjedës janë kushtim për ruajtjen dhe mbrojtjen e tërësisë truallësore të kombit e popullit shqiptar, duke u shprehur qartë e katërcipërisht edhe nëpërmjet toponimisë që përmend e shtie në vargjet e veta, si p.sh.:

"Prej Tivarit e n/Prevezë,/ Nji a gjuha e kombi n'/ Ku lëshon dielli njato rreze/ Qi veç toka jote i di". Askush më bukur, po edhe aq me forcë e ndikim në thelb të zemrës së popullit, nuk i ka kënduar njësisë dhe përbashkësisë së dy dialekteve të shqipes, sa Ndre Mjeda, kur thotë: "Geg'e Toskë, Malci, jallija./ Jan nji komb, m'u da s'duron/ Fund e majë nji a Shqypnia./ E nji gjithë t'gith' na bashkon".

Kësaj ideje madhore (të njësisë dhe përbashkësisë së shqiptarëve, të lidhur me një gjuhë "shejta" e të vetme) Mjeda i është qasur e rik-

thyer disa herë e gjithmonë me theksim e ton kushtimor, si p.sh. te vjersha "Bashkonju", ku ai thërret: "Mblidhn'ju vllazën, e bashkon'ju/ Nen flamur të Shqyptaris'/ Prej nji gjaku, nji gjinis/

Å shqyptari kand e kand./ Nji gjuhe shejta t'gith kuvësim/ Nji istori, nji atdhe ne kemi./ Geg'e Toskë nji zemre jemi/ Me ndjekë Shqypte hovin tand."

Mjeda ishte teolog, shkriar, gjuhëtar, deputet, themelues i shoqërisë kulturore "Agimi", hartues i alfabetit shqip. Ka qenë një punë shumë e vlefshme e me rëndësi të madhe kombëtare krijimi i Qendrës Muzeore "Dom Ndre Mjeda", pikërisht në shtëpinë e kishën ku ka vepruar poeti ynë i madh dhe për hir të punës së madhe të Dom Nik Ukgjinit, së bashku me institucionet e larta të shtetit, me donatorë e dashamirës të kulturës janë përvijuar realizuar projektet e njëpasnjëshme pranë kësaj qendre dhe sot është krenari, që kjo qendër kulturore funksionon dhe tërheq njerëz elitare nga Shqipëria e më gjerë. Këtë qendër e kanë vizituar dhe kanë marrë pjesë në aktivitetet të përvitshme që nga viti 2012 një numër i konsiderueshëm përfaqësuesish të trupit diplomatik në Shqipëri, udhëheqës e politikanë nga Shqipëria dhe nga Kosova, akademikë, studiues, shkriarimë, poetë, pedagogë, mësues, studentë, nxënës shkollash etj.

Ja pse, edhe në veprimtarinë e djeshme, mora pjesë më kënaqësi dhe, në paça jetë e shëndet, përsëri do të marr pjesë e do të kumtoj për vlerat e pavidra të poetit, gjuhëtarit, atdhetarit dhe njeriut të shquar, Dom Ndre Mjeda.

HOROSKOPI

DASHI
Mbrëmja do të jetë e shumëngjyrshme nga vizione romantike, falë pozicionimit të Hënës në lidhje me Venusin. Përfiton nga momenti dhe përgatitni një darkë të këndshme. Gjesti juaj do të vlerësohet se tepëri, mbi të gjitha sepse kishit kohë që nuk bënit gjëra të tilla.

DEMI
Shfaqni hapur pa frikë ndjenjat tuaja, sido që të jenë ato. Nuk do të jetë aspak e lehtë t'u fshiheni të tjerëve. Mos kini frikë të mbroini bindjet tuaja, edhe pse e tejkaloni masën. Duke gabuar, mësohet.

BINJAKET
Merkuri dhe Plutoni ju shtynë drejt aventurës dhe ndryshimeve të papritura. Por, para se veproni, mendohuni dy herë. Disa hapë të ndërmarrja mund t'ju çojnë që të bëni disa zgjedhje të rëndësishme, që do të përfundojnë duke ju ndryshuar jetën.

GAFORJA
Disa kontestime, sipas jush jo të drejta, mund të bëjnë që të humbni disa entuziazmin. Mos u jepni atyre asnjë rëndësi dhe vazhdoni në rrugën tuaj. Nëse jeni të sigurt në vetvetë, mos u ktheni mbrapa.

LUANI
Vlerësime të shumta ju bëjnë më të përgjegjshëm dhe më të sigurt. Eshhtë e sigurt që njerëzit mund të mbështeten tek ju, edhe në rrethanat më të ndërlikuar. Një punë e thelluar do të bëjë që të keni më shumë të ardhura. Do të fitoni me pak, por do t'ia dilni të ngriheni lart.

VIrgjeresha
Për faj të pozicionimit të Hënës në lidhje me Jupiterin, sigurtësi tuaja do të rezultojë këshillja prej rëre, mbi të cilat nuk mund të keni më besim. Eshhtë më mirë të ecni me ngadalë për të mos u rëzuar.

PESHORJA
Përfiton nga kthjelltësia dhe vëgjitëna e reflektive, për të kaluar një sprovë mjaft të vlefshme. Jeni një hap përpara, është e pamundur ta mohoni! Nuk do të jetë e lodhshme për ju të merrni pas edhe të tjerët, duke qenë se do ta kuptojnë se idetë tuaja kanë bazë të shëndoshë.

AKREPI
Deri në gjysmën e kësaj jave, nëse puna ka qenë më e lodhshme së zakonit, mund të ndjeni një rëndësi të entuziazmit, por më pas do të jeni sërish në formë! Kushtojni vetes momente çlodhjeje për të qendruar me partnerin, do t'ju ndihmojë të qetësoheni.

SHIGJETARI
Ndërojtja dhe tërheqja mund të jenë problem, nëse gjendeni përpara personave që nuk i njihni mirë. Përpunoni të shfaqeni më të vendosur. Mirëpririmi nisë pa frikë, mbi të gjitha nëse bëhet fjalë vetëm për gjëra të mira.

BRICJAPI
Në vend që të shpikni justifikime, gjë për të cilat jeni kampionë absolutë, përvishni mënjëjtë deri sa të zgjidhet gjithçka në kohën e parashikuar. E keni kuptuar se është e kotë të qaheni, më mirë mos e harxhoni frymën për të përshpejtuar gjërat.

UJORI
Nëse në të kaluarën nuk ia keni dalë të shfrytëzoni të gjithë potencialin e një situatë shumë premtuese, tashmë pozicionimi i Hënës tek Shigjetari do t'ua japë mundësinë. Mos rrii duarkry, sepse tani është momenti që të përshpejtoni për të arritur një objekt të dëshiruar.

PESHQIT
Eshhtë më mirë të mos nxitoni dhe t'i bëni gjërat në kohën e duhur. Një karakter i fortë mund të jetë një thikë me dy presë, prandaj bëni kujdes nga sjelljet joproduktive.

Katovica

Linçimi serb i Izetbegoviçit dhe heshtja shqiptare

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

Kosova dhe Shqipëria kanë bërë gabimin e madh që nuk kanë reaguar asnjëherë për veprimtarinë e pandërprerë të Serbisë dhe të diplomacisë së saj nëpër botë për mosnjohjen e Kosovës.

... drejtën e fjalës të qytetarëve në shtetet e tjera ballkanike. Arroganca shtetërore serbe në shkeljen e të drejtave të lirisë së fjalës dhe të shprehjes në shtetet e tjera mori një përmasë të frikshme me fushatën zyrtare serbe të linçimit personal dhe politik të anëtarit të Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, Bakir Izetbegoviç. Preteksti që shpërthoi e një opinioni personal të anëtarit të Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, i cili në një intervistë në "Dojçe Vele" në datën 13 nëntor deklaroi se "Bosnjë-Hercegovina duhet ta kishte njohur Kosovën deri tani, por kjo kërkon një konsensus në nivel shtetëror". Pra, Bakir Izetbegoviç shprehu një opinion në një intervistë shtypi se shpresonte që Bosnjë-Hercegovina ta njohë Kosovën. Ai nuk tha se entiteti boshnjak do ta njohë në mënyrë të njëanshme Kosovën, nuk ndërmori ndonjë hap zyrtar apo nismë politike, juridike apo legjislative në Sarajevë për njohjen e Kosovës, por thjesht shprehu një opinion për qëndrimin që duhet të mbajë Bosnjë-Hercegovina ndaj Kosovës. Izetbegoviç e din më mirë se të tjerët dhe e shprehu qartë këtë në intervistë se njohja nuk mund të arrihet pa konsensusin e entiteteve të tjera përbërëse të shtetit të Bosnjë-Hercegovinës.

Mjaftoi vetëm shprehja e opinionit të drejtë të Bakir Izetbegoviçit për nevojën e njohjes së Kosovës dhe Beogradi zyrtar shpërthoi një histori të vërtetë politike, nacionaliste dhe antinjerëzore kundër të drejtës së shprehjes së lirë të mendimit nga një qytetar i një shteti tjetër: Ministri i Brendshëm dhe disa ministra të tjerë të kabinetit serb rinxorën nga arkivat fjalorin më të shëmtuar radikal të kohës së Millosheviçit për të sulmuar Izetbegoviçin dhe popullin boshnjak dhe për të kërcënuar për destabilizim të rajonit. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, në 14 nëntor kërcënoi se deklarata e Izetbegoviçit "do të ketë pasojë afatgjatë politike dhe juridike". Dhe si për t'i vënë vulën etnes radikale nacionaliste, që ka kapluar mendjet e udhëheqësve serbë, presidenti Vuçiç mbodhi në datën 15 nëntor Këshillin e Sigurisë Kombëtare të Serbisë për të shqyrtuar deklaratën e Izetbegoviçit për Kosovën.

Përtej faktit të mungesës së një shteti serioz, fushata e linçimit dhe e shkeljes së të drejtave të lirisë së shprehjes dhe të mendimit në shtetet e tjera ka një domethënie të rrezikshme për politikën rajonale të Serbisë, për dinamikën e bashkëpunimit rajonal dhe për zhvillimet e ardhme në Ballkan.

Serbia shfaqet si shteti që drejtohet nga udhëheqje dhe nga mentalitete nacionaliste dhe shoviniste, që i jep vetes tagrin të diktojtë se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë duhet të thonë në vendet e tyre udhëheqësit e shteteve të tjera. Në këndvështrimin mbarëshqiptar çështja bëhet edhe më e rëndë, sepse anëtar i Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës po sulmohet e po linçohet, sepse deklaroi mendimin e tij që Beogradi po shkel marrëveshjet e arritura në Dejton në bazë të të cilave Serbia e njohu shtetin e Bosnjë-Hercegovinës. Kjo don të thotë që për Serbinë, sovraniteti dhe integriteti i Bosnjë-Hercegovinës është formal dhe i përkohshëm, përdërisa ajo i jep vetes të drejtën të lejojë apo të ndalojë udhëheqësit boshnjakë të shpre-



Me këtë fushatë linçimi kundër udhëheqësit boshnjak për Kosovën, presidenti dhe udhëheqja e sotme e Serbisë dëshmojnë se ata nuk janë shpërndarë nga kursi i vjetër nacionalist dhe radikal, që i jep Serbisë të drejta ekskluzive mbi shtetet e dala nga ish-Jugosllavia. Nga kjo histori e pashembullt kundër Kosovës dalin në dritë dy elemente të rëndësishme. Së pari, që i ashtuquajtur i dialog i brendshëm i Presidentit të Serbisë për çështjen e Kosovës është një nismë demagogjike për të mashtruar BE-në, për të blerë kohë dhe për të mos pranuar shtetin e pavarur të Kosovës. Së dyti, që bisedimet, të cilat Serbia zhvillon me Kosovën në Bruksel me ndërmjetësimin e BE janë bisedime për hir të bisedimeve dhe një alibi e Serbisë për të shmangur kushtin e BE për njohjen e Kosovës përpara anëtarësimit.

Heshtja e Prishtinës dhe e Tiranës për fushatën antiboshnjake janë pika diplomatike në dobi të Serbisë.

hin opinionet e tyre. BE shikon edhe hesht ndaj këtij zhvillimi negativ serb dhe ndaj shkeljes së normave të fqinjësisë së mirë nga Serbia. Histeria zyrtare serbe ndaj udhëheqësit boshnjak inkurajon kursin separatist të të ashtuquajturës "serpska republika" drejt prishjes së shtetit të Bosnjë-Hercegovinës, shkëputjes së "serpska republikës" dhe bashkimit të saj me Serbinë. Heshtja e Brukselit inkurajon presidentin separatist të "serpska republikës", Milorad Dodik, i cili në datën 13 nëntor, në kulmin e fushatës serbe kundër Izetbegoviçit, deklaroi përsëri: "Unë dua që 'serpska republika' të shkëputet. 'Serpska republika' është çështja më e rëndësishme kombëtare e Serbisë".

Heshtja e Brukselit për fushatën e linçimit të udhëheqësit boshnjak nga Serbia për çështjen e Kosovës mund të kuptohet si vazhdim i politikës së gabuar të indulgjencave që BE ka ndjekur dhe po ndjek ndaj Serbisë, sipas mendimit të gabuar evropian se me lëshimet ndaj udhëheqjes serbe, ajo do të bëhet më europiane.

Por, ajo që për mendimin tim është e paqartë dhe e pakuptueshme është heshtja e Kosovës dhe e Shqipërisë ndaj këtij zhvillimi negativ dhe më konkretisht ndaj linçimit të udhëheqësit boshnjak nga Serbia për shkak të Kosovës. Pra, në mes është çështja e Kosovës dhe goftë Prishtina, goftë Tirana,

duhet ta kishin përshëndetur udhëheqësin boshnjak për deklaratën e tij pozitive në favor të njohjes së shtetit të Kosovës. Bakir Izetbegoviç është anëtar i Presidencës trepalëshe të Bosnjë-Hercegovinës, është udhëheqësi dhe zyrtari më i lartë i popullit boshnjak, që është popull shumicë në shtetin e Bosnjë-Hercegovinës. Deklarata e tij në favor të njohjes së Kosovës duhet vlerësuar si ndihmë ndaj Serbisë që të reflektojë mbi një realitet, të cilin e kanë njohur të gjitha shtetet, që kanë dalë nga ish-Jugosllavia. Kosova dhe Shqipëria duhet ta kishin përshëndetur dhe duhet të ishin pronuar në favor të tij dhe të nevojës për njohjen e Kosovës nga Bosnjë-Hercegovina dhe nga Serbia. Heshtja e Prishtinës dhe e Tiranës për fushatën antiboshnjake janë pika diplomatike në dobi të Serbisë. Dhe është e mjerë pozita e mediave të Tiranës, të cilat nuk e zunë fare në gojë deklaratën e udhëheqësit boshnjak për njohjen e Kosovës, fakt ky që dëshmon influencën e lobi serb në mediat e Shqipërisë.

Është një rast i shkëlqyer diplomatik dhe politik që Kosova dhe Shqipëria t'i tregojnë Serbisë se njohja e Kosovës është një interes jetik goftë i Kosovës, goftë i Shqipërisë. Është rast i përshatshëm që Kosova dhe Shqipëria t'i tregojnë Serbisë se ajo nuk mund të ndërhyjë në punët e brendshme të shteteve të tjera dhe të ndalojë njohjen e Kosovës. Prishtina e Tirana duhet t'ia bëjnë të qartë jo vetëm Serbisë, por edhe shteteve të tjera në fund të botës si Surinami apo Guine Bissau, që po luajnë me njohjen e Kosovës.

Kosova dhe Shqipëria kanë bërë gabimin e madh, që nuk kanë reaguar asnjëherë për veprimtarinë e pandërprerë të Serbisë dhe të diplomacisë së saj nëpër botë për mosnjohjen e Kosovës. Kosova dhe Shqipëria kanë bërë gabim të madh që nuk kanë reaguar asnjëherë në BE për këtë veprimtari të Serbisë nëpër botë kundër njohjes së Kosovës. Ka qenë i papranueshëm mosreagimi shqiptar në shkallë ndërkombëtare, por është dy herë më i papranueshëm kur është fjala për rajonin tonë. Çfarë shprehe dhe iluzioni ka Kosova se do ta njohë Serbia, kur udhëheqësit serbë kanë brenda mendjes dhe shpirtit të tyre një urrejtje kaq të madh nacionaliste ndaj Kosovës. Çfarë shprehe dhe iluzioni ka Shqipëria se do të ndërtojë vëllazërimin serbo-shqiptar apo vëllazërimin ballkanik me ahengje ballkaniko-perëndimore, kur udhëheqësit serbë kanë një urrejtje nacionaliste ndaj Kosovës dhe ndaj shqiptarëve.

Nuk mund të imagjinohet se çfarë shpresohet se arrihet me këtë memçllëk shtetëror dhe diplomatik: a do të bëhet Serbia më e dashur apo do të merret ndonjë fletë lavdërimi për "moderim". Në të dyja rastet Kosova dhe Shqipëria dalin të humbur. Nuk duhet harruar se në goftë se në marrëdhëniet rajonale dhe ndërkombëtare Kosova dhe Shqipëria nuk mbrojnë udhëheqësit miq dhe shtetet mike, që njohin Kosovën, të mos shpresojnë për forcimin e pozitive ndërkombëtare të Kosovës, të Shqipërisë dhe të faktorit shqiptar. Nëse Shqipëria dhe Kosova nuk flasin në rajon, për çfarë mendojnë se do t'u dëgjohejt zëri, për Korenë e Veriut apo për Iranin? Miq të Kosovës dhe të Shqipërisë janë ata që e njohin dhe duan të njohin Kosovën dhe jo ata që dua ta varrosin Kosovën me temjanin e Millosheviçit.



Sulmuesi nuk festoi në respekt të ish-tifozëve

"Hakmarrja" e ëmbël e Plakut: Korça më sjell fat

Pasi u shpall njeriu i ndeshjes Skënderbeu-Kamza, sulmuesi Sebino Plaku u shpreh se qyteti i Korçës i sjell fat, pasi është një ambient fantastik për një futbollist, por tha se nuk mund të festonte, pasi aty ka kaluar momente shumë të

mira dhe ka respekt për njerëzit dhe qytetin. Ai gjithashtu tha se te Kamza po kalon një periudhë të artë dhe se për të, rëndësi ka të luajë dhe të shfaqë veten e jo vetëm të jetë pjesë e një ekipi me emër, ku mund të mbetet lojtar stoli. "Këtu ka

qenë periudha më e mirë e karrierës sime. Këtu kam kaluar futbollin më të mirë. Mendoj se është ambienti më i mirë për një futbollist të shfaqë aftësitë e veta. Kamza? Rezultatet pozitive po vijnë dhe na shijon, sidomos për një ekip që vjen nga Kat-

egoria e Dytë. Sot bëmë një lojë shumë të mirë. Skënderbeu na e imponoi lojën e vet, por në fund morëm një pikë në një fushë ku të tjerët mendoj se nuk do e marrin. Goli? Është hera e parë që shënoj kundër Skënderbeut. Është një ndjesi e veçantë. U mundova të mbaç emocionet, sepse kam kaluar një periudhë fantastike te ky ekip. Isha i detyruar t'ia ktheja pas këtë respekt".



Jeton Selimi

Në "Niko Dovana", Teuta thyen Vllazninë. Liçaj në shtesë i jep 3 pikët Flamurtarit ndaj Lushnjës

Kamza befason Skënderbeun në Korçë

Radas shënon për korçarët, barazon Plaku

E diela e Superligës është mbyllur me dy ndeshjet e orës 17:00. Në Korçë, Kamza ka befason Skënderbeun teksa ka mundur të shkëpusë një pikë në fushën e kryesuesve të kampionatit. Loja ka qenë e bukur dhe me raste të mira shënimi për të dyja ekipet, por goli do të vijë vonë. Në minutën e 66-të Marko Radas shpik një goditje dënimi të shkëlqyer, duke thyer portierin Halilaj për gëzim e të zotëve të shtëpisë. Ishte tentativa e tretë e kroatit kjo, ndërsa në dy të parat gjeti vetëm rrjetën e jashtme. Gjithsesi, kur duket se Skënderbeu do të arkivonte fitoren e nëntë në këtë kampionat, Sebino Plaku ka marrë një top nga thellësia dhe në sprint ka djegur mbrojtjen vendëse për të ndëshkuar Shehin. Nuk feston ish-sulmuesi i Skënderbeut, por goli i tij ka vlera të jashtëzakonshme, me Kamzën që konfirmohet dhe njëherë si surpriza e këndshme e kësaj Superlige.

NË DURRËS

Nuk ka histori ndeshja në Durrës. Teuta mposht Vllazninë në "Niko Dovana", me shkodranët që duket se nuk po gjejnë shpëtim as te "kura" e Ernest Gjokës. Në

minutën e 15-të Çyrbja ka përfutuar nga një spastrim i keq i topit nga ana e mbrojtjes shkodrane dhe shënon golin e vetëm të takimit, me Teutën që ngjitet në kuotën e 14 pikëve, ndërsa Vllaznia mbetet e parafundit dhe në krizë të thellë rezultatesh.

NË LUSHNJË

Duhej të vinte koha shtesë që Flamurtari të thyente Lushnjën, që nga ana e saj po bënte qëndrësë të fortë ndaj vlonjatëve. Madje, duhej të vinte ky eurogol i Liçajt që Spaho të dorëzohej i dëshpëruar. Një roveshatë e shkëlqyer e mesfushorit, që u jep të paktën për një



ditë kuqezinjve vendin e dytë, pasi Flamurtari shkon në kuotën e 20 pikëve, një më shumë se Kukësi i vendit të dytë, që do luajë të hënën ndaj Partizani.

Në "Roza Haxhiu" Lushnja shfaqet e mirëvendosur në fushë, ndërsa Flamurtarit i mungon grinta, që mesa duket e kishte harxhuar në ndeshjen ndaj Skënderbeut. Praktikisht Spaho dhe Nurkoviç kanë

TRAJNERI I SKËNDERBEUT "QAN" MUNGESAT

Daja: Barazimi me Kamzën nuk është fundi i botës

Trajneri i Skënderbeut, Ilir Daja është shprehur i pa kënaqur nga barazimi ndaj skuadrës së Kamzës. Strategu i ekipit të korçarëve ka kritikuar mbrojtjen për pësimin e golit. "Na vjen keq që pësuam një gol në atë formë. Duhet të marrim gjithmonë 3-pikëshin si në shtëpi, ashtu edhe në transfertë. Lilaj dhe Jashanica janë dy mungesa të mëdha. E kemi mbajtur pothuajse gjatë gjithë kohës kundërshtarin në zonën e tyre, por gjithsesi futbollit i ka këto. Në rastin e golit, situata duhej vlerësuar ndryshe nga mbrojtësit tanë. Në atë rast duhet vetëm që të ruanin distancën e sigurisë. Mbrojtja gaboi, por jo vëmendja e duhur solli dhe atë gol që barazoi rezultatit. Klasifikimi na lejon që të jemi në gjendje komode. Pritshmëria ka ardhur nga paraqitja që kemi bërë. Nuk fundi i botës që sot barazim. Kamza është një skuadër e fortë dhe e ka treguar këtë gjë në kampionat. Kemi tentuar që të bëjmë rotacion në ndeshjen e parë. Lojtarët që futen nuk janë në ritmin e futbollistëve që luajën nga minuta e parë në shumicën e ndeshjeve. Ata mund të kenë cilësi individuale, por duhet të përshatën me pjesën tjetër të ekipit. Futbollistët që dëshiron të luajnë si titullar te Skënderbeu duhet që ta meritojnë dhe jo ta kërkojnë", tha Daja për "Super Sport".



SERIA A

Sampdoria trondit Juventusin, ndalet edhe Fiorentina

Juventus pëson humbjen e dytë në këtë sezon në Seria A. Kampionët e Italisë janë mundur sot nga Sampdoria me rezultatit 3-2. Sampdoria ishte cinike në rastet e saj, duke shënuar 3 herë në portën e mbrojtur nga Shezini. Në pjesën e parë, Juventusit kushte nën kontroll lojën, por nuk arritën që të konkretizojnë rastet e tyre. Në fraksionin e dytë, Sampdoria kalon në avantazh me Zapatën në minutën e 52. Vendësit nuk ndalen me kaq, teksa Torreira shënon një gol fantastik në hyrje të zonës. Në fundin e ndeshjes, Ferrari shënon golin e tretë, duke u dhënë një goditje të fortë bardhezinjve. Në fundin takimit, Gonzalo Higuain shënoi nga pika e bardhë, ndërkohë që Dybala realizoi golin e dytë, duke ndezur shpresat e bardhezinjve vetëm për 1 minutë. Pas kësaj humbjeje, Juventusit mbetet 4 pikë larg nga Napoli. Në ndeshjet e tjera, Fiorentina barazoi 1-1 në mënyrë surprizuese me SPAL, ndërkohë që Torino u ndal në të njëjtën rezultat ndaj Kievos.



MODESTIA

Ndreu: Objektivi i Kamzës është mbijetesa

Barazimi në transfertë ndaj një skuadre të madhe si Skënderbeu e kënaq pa masë trajnerin e Kamzës, Ramadan Ndreu. Në prononcimin pas ndeshjes për mikrofonin e "Supersport", tekniku tregon sekretin e marrjes së rezultateve pozitive. "Në përgjithësi ishte lojë e mirë. U mbrojtëm shumë mirë. E kishim vështirë të sulmonim, sepse skuadra e Skënderbeut ka nivel. E kishim ndërtuar strategjinë që në qoftë se Skënderbeu të linte një hapësirë ta ndëshkonim. Hëngrëm një gol të çuditshëm për shkak se u hap barrikada. Grupi është i etur për të ecur dhe për të fituar. Djemtë janë të dëgjueshëm dhe me karakter. Plus kanë përkushtim të jashtëzakonshëm. Gjej rastin t'i falënderoj. E rëndësishme është që morëm pikët që duhen për të mos rënë nga kategoria, nuk kemi siguruar asgjë. Ky kampionat është shumë i fortë, në çdo moment trëshqet në fund nëse gabon. Por nëse ecim me këto, hapa mund t'i afrohem Europës".




MBROJTËSI I REALIT

Ramos: Do derdh 'gjak' gjithmonë për këtë fanellë

Derbi i djeshëm spanjoll midis Atletiko Madrid dhe Real Madrid ka përfunduar në barazim 0-0. Një episod i rrezikshëm ka ndodhur në fundin e takimit, teksa Lukas Hernandez e ka ekzagjeruar me ndërhyrjen e tij. Takat e futbollistit kanë prekur fytyrën e mbrojtësit të Realit, që në ato momente ishte në zonën kundërshtare. Serxho Ramos është gjakosur në fushën e lojës, edhe pse dëshira e lojtarit kundërshtar ishte për të larguar topin, gjithsesi ajo goditje ishte shumë e rrezikshme. Vetë mbrojtësi spanjoll ka shkruar në llogarinë e tij personale në "Twitter" këto fjalë: "Do të derdh 'gjak' njëmijë herë nëse është e nevojshme për këtë fanellë. Faleminderit për mbështetjen tuaj! Do të rikthehem si asnjëherë më parë", është shprehur Serxho Ramos.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Një pjesë e perandorisë
- Duhen marrë kolegjalisht.
- Qytet rus
- Fillojnë daljen.
- Të lë në mëdyshje.
- Një pjesë teatrale për të qeshur
- Është publiku i San Siros.
- Janë botimet e përmuajshme.
- Mbyllin aeroporte.
- Në krye të titullarëve.
- Ishte gruaja që i dha ujë nga pusi Krishtit
- Bëjnë zoom të tillë.
- Inicialet e Kazan regjisor.
- Centrale Autonome Daneze.
- Është e kundërt e analizës.
- Qe mjeku i Mark Aurelit.
- Një enë
- Pulat pa kufij.
- Është për të ushqyer foshnjat me qumsh.

- Emri i Pirandellos.
- Një fjalë si akoma
- Në mes të Salt dhe City
- Jean që qe aktor.
- Mbyllin takimet
- Është edhe ajo e cirkut
- Kapiteni i Nautilus.
- ... mosketerët e Dumas.

VERTIKAL

- Një fjalë e pamjaftueshme.
- Qe fabulist i famshëm
- Janë ciganët.
- Hapin vallen.
- Është influencim.
- Janë amatorët
- Pak ilaritet
- Një pjesë e mendimeve.
- Është budallaçka.
- Një fjalë e freskët.
- Një emër i njohur i modës.
- Me Odiseun u vodhi Palladin trojanëve.
- Elvira aktore.
- Pal... ish futbollist i yni.
- Një pjesë e dardanëve.
- Është marsejeze... për çati.
- Është ylli më i shndritshëm i Akrepit
- Liam aktor
- Mund të jetë një koncert.
- Kështu flet ai që është mbi kalë.
- Janë shtetet e ndara nga feja.
- Sean aktor.
- Stoker që shkroi Dracula.
- Një që bëhet si favor.
- Tre në Genesaret.
- Mbarojnë fare
- Diftong për serioz.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Irene aktore.
- Gjysma e kulmit.
- Fillojnë vetëm.
- Qytet rumun
- Mund të jenë me sahat.
- Elliott Gould.
- Inicialet e Altman regjisor.
- Thomas Alva shpikës i famshëm.
- Lumë në Spanjë.
- Ndasheshin me sinorë.
- Zbuloi Tokën e Van Diemen.
- Kush nuk ka... nuk i ecën.
- Një kapak me titull.
- Inicialet e Turgeniev.
- Janë provat që administrohen.
- Na kanë paraparirë.
- Rubinstein që qe pianist.
- Fundi i një fukarai.
- Gardner aktore.
- Këndon me Paolan.


- Mish pa kocka.
- Mbahet në fund.
- Diftong teorik.
- E drejta romake.
- Është transporti si kamion.
- Eastwood i kinemasë.
- I vocërr ai i Migjenit.
- Është numri 1.
- Është aftësia e kondensatorit
- Janë ciganët.

VERTIKAL


- Është material për qiri.
- Mali ku ngeci Arka e Noes.
- Fillojnë panikun.
- Një zakon.
- Gjysmë sistem.
- Janë zotj të verdhë.
- Në fund të krahut.
- Shkroi Michel Strogoff.
- Gjysmë egoist.
- Përbindëshi i labirintit.
- Vertetojnë firma të tillë.
- Emri i Zola.
- Është si shtëpi.
- Mbyllin portat.
- Ka tribuna me shkallë.
- Mund të jetë telefonike.
- Charles që krijoi Gishtos.
- Pineda e Garcia Lorca-s.
- Janë të palëvizshmet.
- Aty ku del kush bie në sy.
- Ashtu si jeton anakoreti.
- Coca... më e famshme.
- Janë të ndryshme në leje.
- Ente Civile Kavajë.
- Shkroi Misteret e Parisit.
- Beton pa kufij
- Kështu përfundon një princip.
- Inicialet e Cruise.
- Kufizojë lëvizjet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



SUDOKU

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 7 | | | | 3 | 9 | 1 | | |
| 9 | | 8 | | | 3 | | | | 4 |
| | | 1 | | 5 | 2 | | | | |
| | 2 | | | 9 | 5 | 8 | 1 | | |
| | | 3 | 6 | | 8 | 7 | | | |
| | 5 | 6 | 1 | 2 | | | 4 | | |
| | | | | 4 | 7 | | 1 | | |
| 4 | | | 2 | | | 5 | | 8 | |
| 6 | 3 | 2 | | | | | 7 | | |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|--|
| 5 | 2 | 1 | 4 | 7 | 9 | 6 | 8 | 3 | |
| 3 | 9 | 4 | 8 | 2 | 6 | 7 | 5 | 1 | |
| 6 | 7 | 8 | 1 | 5 | 3 | 4 | 9 | 2 | |
| 9 | 3 | 5 | 6 | 1 | 2 | 8 | 7 | 4 | |
| 8 | 6 | 2 | 7 | 9 | 4 | 3 | 1 | 5 | |
| 1 | 4 | 7 | 3 | 8 | 5 | 9 | 2 | 6 | |
| 4 | 8 | 9 | 2 | 3 | 1 | 5 | 6 | 7 | |
| 7 | 1 | 6 | 5 | 4 | 8 | 2 | 3 | 9 | |
| 2 | 5 | 3 | 9 | 6 | 7 | 1 | 4 | 8 | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Disa cilësi janë tepër të mira për të prishur shijen me lëvdata. (Ralf Valdo Emerson)
- Kërkesa për saktësi bllokton kërkesën për përmbajtjen. Pasantësia është premisë që shtyn njeriun të shpallë fuqitë e tij. (Erih From)
- Statistikat nuk e zëvendësojnë gjykimin. (Henri Klej)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



Thënie të mençura

- Forca shpirtërore s'është gjë tjetër, veçse arti për të mbajtur mbyllur në zemër shqetësimin.
- Nuk ka rëndësi kush të zhgënjëu, apo kush të rrëzoi, rëndësi ka kush të bëri të buzëqeshësh sërish.
- Vlera e një njeriu duhet parë në faktin se çfarë jep, dhe jo në atë se çfarë është në gjendje të marrë. (Albert Anjshajtj)
- Është më mirë t'i meritoni nderet dhe të mos i gëzoni ato, se sa t'i gëzoni dhe të mos i meritoni. (Mark Tueni)

